



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

---

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43, Tiranë

Tel : ++ 355 4 2259 571

Fax : ++ 355 4 2259 106

[www.akep.al](http://www.akep.al)

**RAPORT**  
**MBI**  
**VEPRIMTARINË E AKEP**  
**PËR VITIN 2012**

Tiranë, Shkurt 2013

---

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

Faks : + 355 4 2259 106

[www.akep.al](http://www.akep.al)

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

Përmbajtja:

I.	HYRJE .....	3
II.	RAPORTI I PUNËS SË AKEP PËR VITIN 2012.....	5
	1. Veprimtaria për autorizimin e hyrjes në treg të sipërmarrësve .....	5
	2. Veprimtaria e rregullimit ekonomik të tregut .....	6
	3. Veprimtaria e rregullimit teknik.....	30
	4. Veprimtaria monitoruese dhe inspektuese.....	34
	5. Veprimtaria juridike për rregullim .....	35
	6. Struktura dhe burimet njerëzore.....	42
III.	STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL DHE MBROJTJA E PËRDORUESVE.....	44
	1. Shërbimi Universal .....	44
	2. Masa për mbrojtjen e konsumatorit dhe përdoruesve fundorë.....	49
IV.	REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË VJETORË TË AKEP .....	51
V.	NGRITJA DHE PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE INFORMATIKE DHE IMPLEMENTIMI I SHËRBIMEVE ON-LINE. ....	56
VI.	STATUSI I REALIZIMIT TE DETYRAVE PER VITIN 2012.....	57
VII.	PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2013 .....	61

## I. HYRJE

Ky raport është përgatitur në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji 9918*) ku kërkohet që në përfundim të çdo viti, AKEP të paraqesë në Kuvend, brenda kater muajve të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës.

Ky material përmban në mënyrë të veçantë :

- Raportin e punës së AKEP për vitin 2012 ;
- Programin vjetor të punës për vitin 2013;
- Raportin për statusin e shërbimit universal; dhe
- Raportimin për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të AKEP.

Në vitin 2012, AKEP ka punuar në realizimin e detyrave të planit vjetor të miratuar të bazuar në percaktimet e ligjit 9918, kuadrin e politikave kombëtare për sektorin, nevojën e tregut dhe rekomandimet e raport-progresit të BE-së për Shqipërinë si dhe Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e AKEP të datës 29.03.2012.

Si ngjarje më kryesore më efekte sinjifikative në sektor për vitin 2012, përmendim:

- **Ndryshimet dhe shtesat e Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".**

Më datë 24.10.2012, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin 102/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Me miratimin e ligjit 102/2012 u arrit finalizimi i një pune afro tre-vjeçare për transpozimin e ndryshimeve të ndodhura në vitin 2009 në paketën rregullatore të BE-së, nepërmjet ndryshimeve dhe shtesave në ligjin 9918.

- **Dhënia e autorizimit individual të tretë për përdorimin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të standardit 3G.**

Më datë 17.12.2012, sipërmarrësit Eagle Mobile, pas një procesi të hapur tenderimi, iu lëshua autorizimi për përdorimin e frekuencave ku mbështetet teknologjia që ofron shërbime të standardit 3G, duke u bërë operator i tretë në vend që ofron shërbime të këtij standardi.

Gjatë vitit 2012, përveç punës për përmbushjen e kuadrit të nevojshëm rregullator të sektorit, AKEP ka punuar në ngritjen dhe përmirësimin e sistemeve informatike për arritjen e objektivit në kalimin në *e-Authority*: ofrimin on-line të shërbimeve "konsumatorëve" të tij, si dhe dixhitalizimin e procedurave të brendshme të përpunimit të informacionit.

Në fund të vitit 2012, bazuar në dispozitat e rregullores së re "Për Autorizimin e Përgjithshëm", miratuar më datë 02.02.2012, pas aplikimit *on-line* nga të interesuarit, në "Regjistrin e Sipërmarrësve" numri i sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, ishte 157 në krahasim me 204 sipërmarrës të regjistruar deri në fund të vitit 2011. Ky aplikim mundësoi zhveshjen e regjistrit nga sipërmarrës me njoftim fiktiv të aktivitetit.

Numri i pajtimtareve celularë aktive në fund të vitit 2012 (pajtimtare që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit)<sup>1</sup> arriti në 3.5 milion, që përbën rritje me 14% në krahasim me vitin 2011, dhe numri i përdoruesve aktive për 100 banorë ishte 125%, përafërsisht i njëjtë me nivelin mesatar të vendeve të BE-së.

Në vitin 2012, ka vazhduar tendenca e rritjes së përdorimit mesatar të thirrjeve telefonike që ka filluar në vitin 2009, dhe rritja vjetore ishte më e madhe se në vitin 2011. Konsumi i thirrjeve është rritur mesatarisht me 14-17% e matur sipas përdoruesve aktivë, ndërsa përdorimi i SMS-ve është rritur ndjeshëm me 75-83%. Një përdorues aktiv ka konsumuar mesatarisht 319 minuta komunikim thirrje telefonike në muaj dhe 35 SMS në muaj.

Rritja e konkurrencës në treg, vazhdimi i reduktimit të tarifave të terminimit midis operatorëve si dhe efekti pozitiv i procesit të bartjes së numrit celular ka sjellë reduktim të vazhdueshëm të tarifave të shërbimeve celulare.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2012, pati rënie me rreth 27000 apo 8% në krahasim me vitin 2011. Rënia ka ardhur për shkak të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom.

Për telefoninë fikse Albtelecom ka ofruar paketa të kombinura: telefoni dhe akses në Internet. Paketat tarifore të konkurrentëve kryesorë të Albtelecom në telefoninë fikse përmbajnë paketa me pajtim mujor të ulët dhe me tarifa të uleta brenda rrjetit si edhe paketa të integruara të telefonisë, Internet dhe televizion në disa raste.

Përsa i përket tarifave për ofrimin e shërbimit Internet, Albtelecom dhe operatorët alternative kanë aplikuar reduktime të ndjeshme të tarifave si edhe rritje të kapacitetit download për paketa dhe/ose rritje të shpejtësisë së aksesit për të njëjtin cmim.

Evolimi i teknologjisë dhe sjelljes konsumatore në drejtim të paketave të integruara dhe të thjeshta (me përfshirje të minutave në pagesën mujore) dhe rritja e kërkesës për akses në Internet, kanë bërë që shtytësi kryesor për zhvillimin e telefonisë fikse të jetë aksesit broadband në Internet.

Numri total i pajtimtarëve me akses broadband në Internet në fund të vitit 2012 arriti në rreth 215 mijë që përbën një rritje me rreth 24% në krahasim me vitin 2011. Numri i pajtimtarëve me akses broadband për 100 banorë është 7.6%, krahasuar me 6.2 % që ishte në fund të vitit 2011. Numri i pajtimtarëve familjare me akses broadband (fiks dhe celular) është rreth 200 mijë apo afërsisht 27% e familjeve.

Numri i përdoruesve celularë që përdorin Internetin GPRS/EDGE (2.5 G) në 2012, arriti në rreth 1.4 milion nga 1.2 milion në 2011, që përbën një rritje me 15%.

---

<sup>1</sup> Në raportet e mëparshme AKEP ka raportuar numrin e pajtimtarëve celulare sipas kartave SIM aktive. Në këtë raport jepen të dhëna për dy mënyrat e matjes së numrit të këtyre pajtimtarëve.

## II. RAPORTI I PUNËS SË AKEP PËR VITIN 2012

### 1. Veprimtaria për autorizimin e hyrjes në treg të sipërmarrësve

Autorizimi i hyrjes në treg të subjekteve për ofrim rrjetesh dhe shërbimesh publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2012, është bërë bazuar në dispozitat e rregullores së re “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1774 datë 02.02.2012, shoqëruar kjo me aplikacionin përkatës *on-line*.

Aplikimi on-line bazuar në kushtet e anekseseve të rregullores, ka bërë të mundur marrjen e një informacioni të detajuar dhe të nevojshëm mbi:

- rrjetet/shërbimet që ofron sipërmarrësi;
- statusin ligjor, shoqëruar me ekstraktin e QKR-së;
- teknologjinë e përdorur dhe mediumet e komunikimit;
- kushtet e ofrimit të aksesit dhe shërbimit pajtimtarit-kontrata tip;

Aplikimi on-line për autorizim të hyrjes në tregun e komunikimeve elektronike, veç të tjerave, saktëson detajet e kontaktit të sipërmarrësit pasi vetë moduli i aplikimit kërkon adrese e-mail funksionale në mënyrë që sipërmarrësi të marrë të dhënat për login “përdoruesin, fjalëkalimin, kodin e konfirmimit”, pranimin apo kthimin për rishikim të aplikimit.

Me zbatimin e kësaj rregulloreje “Regjistri i Sipërmarrësve” është më i detajuar dhe i organizuar, duke lehtësuar identifikimin e sipërmarrësit dhe rrjetet/shërbimet e ofruara prej tij.

Sa më sipër, pas aplikimit në bazë të rregullores së re në “Regjistrin e Sipërmarrësve” numri i sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, është 157 në krahasim me 204 sipërmarrës të regjistruar deri në fund të vitit 2011. Ky aplikim mundësoi zhveshjen e regjistrit nga sipërmarrës me konfirmim fiktiv të aktivitetit.

Nga sipërmarrësit e regjistruar kanë njoftuar:

- shërbimin publik telefonik të lëvizshëm 4 sipërmarrës;
- shërbimin publik telefonik fiks 73 sipërmarrës;
- shërbimin publik transmetim të dhëna 53 sipërmarrës;
- shërbime me vlerë të shtuar 33 sipërmarrës;

#### 1.1 Shërbimet e lëvizëshme ajrore, detare dhe radioamatore.

Bazuar në kërkesat e rregulloreve përkatëse ka përfunduar brënda afatit të caktuar shqyrtimi i aplikimeve dhe në vitin 2012, kemi këtë gjëndje në regjistrat përkatës:

- liçensë për stacionet radio të anijes- për 19 subjekte
- liçensë për stacionet radio të avionit-për 6 subjekte
- liçensë për autoritetin e llogarive detare dhe kodin AAIC- për 1 subjekt
- çertifikatat e operatorëve radio detarë- për 46 individë
- autorizim për stacionet radio bregdetare 5.

Në vitin 2012, janë lëshuar dhënë dhe regjistruar këto liçenca/çertifikata radioamatore:

- a) për radioamatorë vëndas

- çertifikata 11;
- liçensa individuale 11;
- liçence radioklubi 1;
- liçencë shoqate 1.

b) për radiomatorët e huaj janë dhëne 12 liçenca të përkoshme individuale.

Informacioni për subjektet/personat e liçensuar dhe të pajisur me çertifikatën për shërbimet e mësipërme janë publikuar në “web site” të AKEP në regjistra të veçantë, përkatësisht:

1. Regjistri i liçensave të stacioneve radio të anijeve;
2. Regjistri i liçensave të stacioneve radio të avionëve;
3. Regjistri i autorizimeve të stacioneve radio bregdetare;
4. Regjistri i çertifikatave të operatoreve radiodetar.
5. Regjistri i çertifikatave/liçensave të shërbimeve radioamatore.

## **2. Veprimtaria e rregullimit ekonomik të tregut**

Gjatë vitit 2012, veprimtaria e AKEP për rregullimin ekonomik të tregut të komunikimeve elektronike ishte e përqëndruar në aspektet e mëposhtme:


- i. Zhvillimi i procedurave të analizave të tregjeve për Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe vendosje të masave rregulluese për:
  - Tregjet e shërbimeve telefonike celulare
  - Tregjet e shërbimeve telefonike fikse: me pakicë dhe me shumicë
- ii. Rregullimi i interkoneksionit nëpërmjet RIO-ve dhe zgjidhjeve të mosmarrveshjeve;
- iii. Miratimi i RUO së Albtelecom
- iv. Rritjen e rolit të AKEP për mbrojtjen e konsumatorit

### **2.1. Panorama e përgjithshme**

Në fund të vitit 2012, numri i perdouresve të telefonisë së lëvizshme (karta SIM aktive) arriti në rreth 5.6 milion duke u rritur me rreth 7% krahasuar me vitin 2011. Ndërsa numri i pajtimtareve aktive (pajtimtarë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) arriti në 3.5 milion, që përbën rritje me 14% në krahasim me vitin 2011. Numri i përdoruesve për 100 banorë në fund të 2012 ishte 198%, për karta SIM aktive dhe 125% e matur me përdorues aktivë.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2012 arriti në rreth 311 mijë, nivel i cili përbën një rënie me rreth 27000 pajtimtarë apo 8% në krahasim me vitin 2011. Rënia ka ardhur për shkak të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me rreth 29 mijë. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri arriti në 11%, nivel që është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE ( me një mesatare prej 40%) dhe vendet e rajonit. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë ndër vite të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe celulare, ku vihet re rritja shumë e madhe e telefonisë celulare dhe rritja shumë e vogël e telefonisë fikse.


**Figura 1. Ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2012**



Sipas të dhënave për vitin 2012, nga Albtelecom dhe operatorët alternativë, Vodafone dhe AMC për numrin e pajtimtarëve me akses në broadband 3G (me karta USB/modem) si dhe vlerësimeve të AKEP, rezulton që numri total i pajtimtarëve me akses broadband në Internet është rreth 215 mijë që përbën një rritje me rreth 24% në krahasim me vitin 2011. Numri i pajtimtarëve me akses broadband për 100 banorë është 7.6%. Numri i pajtimtarëve familjare me akses broadband është rreth 200 mijë apo afërsisht 27% e familjeve.

Grafiku i mëposhtëm jep në mënyrë krahasimore normat e penetrimit në Shqipëri të shërbimeve të telefonisë fikse, celulare dhe aksesit broadband me vëndet e BE.

**Figura 2. Krahasimi i normave të penetrimit: Shqiperi vs mesatare e BE27**



### Tregues Financiare<sup>2</sup>

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2011 ishin 51922 milion lek të cilat përbëjnë një reduktim prej rreth 9 % në krahasim me vitin 2010 kur të ardhurat ishin 57087 milion LEK. Ky reduktim i të ardhurave është në tendencë të kundërt me volumin e shërbimeve të cilat janë rritur ndjeshëm gjatë vitit 2011 (Internet dhe telefoni celular).

Reduktimi i të ardhurave të sektorit rezulton të jetë kryesisht si pasojë e reduktimit të të ardhurave të operatorëve celularë gjatë vitit 2011, të ardhura të cilat ishin 39.2 miliard lekë, që përbën një reduktim prej 7% në krahasim me vitin 2010, kur të ardhurat ishin 41.9 miliard lekë. Ndërkohë rënie në të ardhura kanë pasur edhe Albtelcom dhe operatorët alternative në total.

Peshën kryesore të të ardhurave të sektorit edhe për vitin 2011 vazhdojnë ta mbajnë operatorët celularë dhe Albtelcom, të cilët së bashku zotërojnë rreth 93 % të të ardhurave të gjithë sektorit, ndërsa operatorët e tjere (Operatorët Alternative) zotërojnë rreth 7% pjesë tregu (rënie nga niveli 8% në 2010). Të ardhurat e operatorëve celularë përbëjnë rreth 75% të të ardhurave të të gjithë tregut (rritje nga 73 % e 2010 për të njëjtët tregues të krahasuar), ndërsa operatori fiks Albtelcom zotëron 18% të të ardhurave të sektorit (një rënie e vogël prej rreth 1 pikë përqindje në krahasim me 2010).


Sipërmarresit alternative ndër më kryesorët sipas të ardhurave mund të vlerësohen operatorët ABcom, Primo ASC, Abissnet, Nisatel dhe Info Telecom të cilët së bashku

<sup>2</sup> Te dhenat financiare te raportuara ne kete raport i referohen vitit 2011, pasi te dhenat financiare per vitin 2012 depozitohen ne AKEP ne muajin Prill 2013.




zënë rreth 5 % të të ardhurave të sektorit, apo rreth 80% të peshës totale të të ardhurave të operatorëve alternative.


**Figura 3. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2011)**



**Figura 4: Ecuria e të ardhurave totale të operatorëve të komunikimeve elektronike (2008-2011)**



**Figura 5: Pjesët e tregut në të ardhura të operatorëve alternative në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2011**



### Investimet

Për sa i përket investimeve të kryera në vitin 2011, tabela e mëposhtëme paraqet të dhënat sipas deklarimeve të operatorëve. Ritje të ndjeshme në krahasim me 2010 paraqesin investimet në rrjete fikse dhe fibrat optikë për rrjete backbone.

**Tabela 1: Investimet e operatoreve te komunikimeve elektronike (2011)**

	2010	2011
<b>Investime në infrastrukture të rrjetet fikse:</b>	<b>1,820</b>	<b>3,254</b>
Rrjet telefonik PSTN/ISDN	524	427
Rrjet IP (ISP), platforma IP	222	1,434
<b>Infrastrukturë rrjet backbone FIBER OPTIKE</b>	<b>1,074</b>	<b>1,393</b>
<b>Investime në infrastrukturë rrjeti celulare</b>	<b>8,089</b>	<b>6,831</b>
<b>Total</b>	<b>9,909</b>	<b>10,085</b>

### Të punësuar

Numri i të punësuarve me kohë të plotë nga sipërmrrësit e komunikimeve elektronike në vitin 2011 ishte 4166 që përbën një rënie të vogël në krahasim me 2010 (4240). Shpërndarja sipas gjinisë tregon se në vitin 2011, 45 % e të punësuarve ishin femra. Sipërmarrësi me numrin më të madh të të punësuarve është Albtelecom me 36 % të të gjithë të punësuarve në tërë sektorin.

**Figura 6: Shpërndarja e të punësuarve në sektorin e komunikimeve elektronike 2011**




Tabela e mëposhtëme paraqet numrin e të punësuarve në sektorin e komunikimeve elektronike në fund të vitit 2011.

**Tabela 2: Numri i të punësuarve në sektorin e komunikimeve elektronike (2011)**

	Operatore Celulare	Albtelecom	Operatore Alternative	Total
<b>Të punësuar me kohë të plotë</b>	1700	1491	975	4166
<b>Prej të cilëve femra</b>	941	597	314	1852

## 2.2 Telefonia celulare


Numri i përdoruesve celularë prej 5.6 milione në fund të 2012, i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfundon para afatit 1 vjeçar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj. Ndërkohë numri përdoruesve që kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit (përdorues aktivë), në fund të vitit 2012 arriti 3.5 milionë krahasuar me 3.1 milionë në fund të 2011. **AKEP gjykon se** ndryshimi në vlerat e cituara më sipër ndodh për shkak se në shifrën e numrit të kartave SIM të përmendura më sipër ka një numër të konsiderueshëm pajtimtarësh me përdorim sezonal, si p.sh emigrantë apo vizitorët në Shqipëri (emigrantet/turistet në periudhen e verës nuk përfshihen në përdorues aktivë), si edhe një numër pajtimtarësh që mund të

mos e përdorin më një kartë SIM, megjithëse ajo rezulton aktive. Praktikën e raportimit ndryshojnë në vende të ndryshme, pasi ka vende që raportojnë numrin e përdoruesve celularë sipas kartave SIM aktive, si edhe vende që raportojnë sipas përdoruesve aktivë. Në referenca të tjera në këtë raport, AKEP i referohet kryesisht numrit të kartave SIM aktive si numri i pajtimarëve celularë, por nderkohë në disa raste jepen edhe tregues bazuar në numrin e përdoruesve aktivë.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë sipas kartave SIM dhe përdoruesve aktivë. Të dhënat për përdorues aktivë janë të disponueshme duke filluar nga viti 2010, pasi më parë raportohesh vetëm numri i përdoruesve sipas kartave SIM aktive. Numri i përdoruesve për 100 banorë në fund të 2012 ishte 198%, për karta SIM aktive dhe 125% e matur me përdorues aktive. Penetrimi sipas përdoruesve aktive ishte i përafert me penetrimin mesatar të vendeve të BE-së.

Numri i përdoruesve sipas kartave SIM u rrit me 7% në 2012 krahasuar me 2011, ku rritjen më të madhe e ka pasur Eagle Mobile me 22% ndersa Plus ka pasur rënien më të madhe me 24%, ndersa numri i përdoruesve aktive në 2012 u rrit me 14%, ku rritjen më të madhe e kishte AMC me 22%, dhe rritjen më të vogël Eagle Mobile me 5%.

**Figura 7. Ecuria e numrit të pajtimarëve celularë 2010-2012**



*Burimi: Të dhënat periodike të operatorëve.*

## **Struktura e përdoruesve celularë 2012**

Tabela e mëposhteme paraqet strukturën e përdoruesve të katër operatorëve celularë për përqindjen e përdoruesve aktivë në raport me numrin e kartave SIM aktive dhe përqindjen e përdoruesve me kontratë në raport me numrin total të përdoruesve.

**Tabela 3. Struktura e përdoruesve celularë 2012**

	AMC	Vodafone	Eagle Mobile	Plus	Total
<b>Raporti Përdorues Aktiv/SIM</b>	75%	74%	31%	67%	63%
<b>Raporti përdorues me Kontrate/SIM Total</b>	9%	5%	14%	28%	10%
<b>Raporti përdorues me Kontrate/ Total Aktiv</b>	12%	7%	46%	42%	16%

Përdoruesit aktivë përbëjnë 63% të numrit total të kartave SIM aktive. Përqindjen më të madhe të këtij treguesi e kanë AMC dhe Vodafone me 75% dhe 74% respektivisht, ndërsa më të ultën e ka Eagle Mobile me vetëm 31%.

Përdoruesit me kontratë zënë 10% të numrit total të përdoruesve të matur me karta SIM. Vlerën më të madhe të këtij treguesi e ka Plus me 28%, ndërsa më të ultin Vodafone me 5%.

Përdoruesit me kontratë përbëjnë 16% të numrit të përdoruesve aktive, ku Eagle Mobile dhe Plus kanë vlerat më të larta me 46% dhe 42% respektivisht, ndërsa Vodafone ka vlerën më të ulët me 7%.

### **Trafiku telefonik dhe struktura e thirrjeve**

Gjatë vitit 2012 thirrjet dalëse të përdoruesve celularë u rriten me 24% në krahasim me vitin 2011, një normë më e madhe rritje vjetore se në 2011 (17%). Rritjen më të madhe e ka pasur Plus me 66% dhe rritjen më të vogël Eagle me 6%. Thirrjet brenda rrjetit përbëjnë 93% të totalit të thirrjeve dalëse duke vazhduar tendencën e viteve të fundit dhe përdorimin e madh të paketave tarifore me tarifa shumë të ulëta për thirrjet brenda grupeve të mbyllur. Pësia e këtyre thirrjeve varion nga 80% në Plus në 95% në Vodafone. Viti 2012, shënoi një rritje të madhe me 94% të numrit të SMS-ve të dërguara nga përdoruesit celularë në krahasim me 2011.


Terminimi i thirrjeve hyrëse nga rrjetet e tjera në vitin 2012 u rrit me 7% në krahasim me 2011. Plus ka rritjen më të madhe me 168% ndërsa AMC dhe Eagle Mobile kanë rënie me 14% dhe 13% respektivisht, ndërsa Vodafone ka një rritje me 6%. Struktura e thirrjeve hyrëse nga rrjetet e tjera ndryshon sipas operatorëve. Thirrjet hyrëse ndërkombëtare përbëjnë mestarisht 72% të thirrjeve hyrëse por që varion nga 34% në Plus në 79% në Vodafone. Thirrjet hyrëse nga rrjetet e tjera celulare përbëjnë mestarisht 26% të thirrjeve hyrëse por që varion nga 19% në Vodafone në 63% në Plus.

### **Të ardhurat e operatorve celularë**

Të ardhurat totale të katër operatorëve celularë gjatë vitit 2011 ishin 39.2 miliard Lekë, që përbën një reduktim prej 6% në krahasim me vitin 2010, kur të ardhurat ishin 41.9 miliard Lekë. Në figuren e mëposhtme paraqitet tendenca e të ardhurave celulare në periudhën 2003-2011, ku mund të vihet re se në vitin 2011 ka pasur një rënie të të

ardhurave në krahasim me vitin e mëparshëm 2010. Gjatë 2011 rënie me të madhe ka pasur AMC me 20% dhe Eagle me 6%. Ndërsa Vodafone ka pasur rritje të vogël me 1%. Plus, si operatori me i ri ka pasur rritje të madhe me rreth 75 herë, por duhet marrë në konsideratë se për vitin 2010 Plus ishte në treg për vetëm 1 muaj.

**Figura 8: Ecuria e të ardhurave të operatorëve celularë 2003-2011**



Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e pjesëve të tregut për 2010-2012 për numër pajtimtarësh, thirrje dalëse dhe SMS dhe për të ardhurat (2009-2012). Nga të dhënat vihet re se pjesët e tregut të AMC janë reduktuar për katër tregues dhe rritje të vogël për SMS. Në 2012 pjesët e tregut të AMC për treguesit e dhënë në tabelë variojnë nga 31-36%. Në krahasim me 2011, Vodafone ka pjesë tregu më të stabilizuara për të gjithë treguesit përveç reduktimit në pjesë të tregut për përdorues me kontratë. Vodafone ka pjesë tregu shumë të madhe për SMS me 73% dhe në nivele 50-52% për thirrje dalëse dhe të ardhura, ndërsa ka pjesë të vogël tregu për përdorues me kontratë. Eagle Mobile ka pjesën më të madhe të tregut për përdorues me kontratë, ndërsa ka një diferencë të madhe në pjesët e tregut të përdoruesve të matura me karta SIM dhe përdorues aktivë (25% dhe 12% respektivisht). Plus në 2012 ka ndryshime të vogla ose të njëjtën pjesë tregu si në 2011 për përdorues (karta SIM dhe përdorues aktivë), thirrje dalëse dhe SMS, ndërsa ka rritje në pjesën e tregut të përdoruesve me kontratë nga 7% në 15%.

**Tabela 4: Pjesët e tregut celularë për disa tregues kryesorë 2010-2012**

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

[www.akep.al](http://www.akep.al)

Faks : + 355 4 2259 106

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

		AMC	VODAFONE ALBANIA	EAGLE MOBILE	PLUS COMMUNICATION
<b>Përdorues (Karta SIM)</b>	<b>2012</b>	<b>33%</b>	<b>36%</b>	<b>25%</b>	<b>6%</b>
	2011	37%	35%	21%	8%
	2010	44%	37%	18%	1%
<b>Përdorues Aktive</b>	<b>2012</b>	<b>40%</b>	<b>42%</b>	<b>12%</b>	<b>6%</b>
	2011	37%	44%	13%	6%
	2010	44%	36%	19%	1%
<b>Përdorues me Kontratë</b>	<b>2012</b>	<b>31%</b>	<b>18%</b>	<b>36%</b>	<b>15%</b>
	2011	35%	24%	34%	7%
	2010	43%	30%	27%	-
<b>Thirrje dalëse</b>	<b>2012</b>	<b>39%</b>	<b>50%</b>	<b>8%</b>	<b>3%</b>
	2011	37%	51%	10%	2%
	2010	46%	45%	9%	-
<b>SMS</b>	<b>2012</b>	<b>36%</b>	<b>73%</b>	<b>20%</b>	<b>1%</b>
	2011	17%	74%	9%	1%
	2010	34%	57%	9%	-
<b>Të ardhura</b>	<b>2011</b>	<b>34%</b>	<b>52%</b>	<b>12%</b>	<b>2%</b>
	2010	40%	48%	12%	-
	2009	42%	49%	9%	-

### **Përdorimi mesatar i shërbimeve celulare**

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mujor për përdorues celularë në 2011 dhe 2012. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Vlerat janë raportuar duke përdorur vlerat e trafikut dalës dhe hyrës gjatë vitit 2012 dhe numrin mesatar të përdoruesve gjatë vitit 2012 (mesatarja e fund vitit 2011 dhe fund vitit 2012). Gjithashtu treguesit janë llogaritur për numrin e përdoruesve celularë sipas kartave SIM dhe përdorues aktive.

**Tabela 5: Përdorimi mesatar i shërbimeve celulare 2011-2012**

	2011	2012	Ndryshimi Vjetor
<b>Përdorues Karta SIM</b>			
Thirrje dalëse në muaj	83	93	12%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	94	103	9%
MOU*	177	195	10%
SMS (dalëse) në muaj	12	21	75%

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

Faks : + 355 4 2259 106

[www.akep.al](http://www.akep.al)

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

<b>Përdorues Aktive</b>			
Thirrje dalëse në muaj	130	152	17%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	147	168	14%
MOU*	277	319	15%
SMS (dalëse) në muaj	19	35	83%

\*Minutes Of Use: Minuta Përdorimi të matura me shumën e thirrjeve të kryera dhe të marra nga një përdorues mesatarisht në muaj.

Në vitin 2012 ka vazhduar tendenca e rritjes së përdorimit mesatar të thirrjeve telefonike që ka filluar në vitin 2009, dhe rritja vjetore ishte më e madhe se në 2011. Konsumi i thirrjeve është rritur mesatarisht me 9-12%, e matur me përdorues sipas kartave SIM, dhe 14-17% e matur sipas përdoruesve aktivë. Përdorimi i SMS-ve është rritur ndjeshëm me 75-83%.

Në vitin 2012, një përdorues celular ka kryer mesatarisht 93 minuta thirrje dalëse dhe ka marrë 103 minuta thirrje hyrëse, duke rezultuar në 195 minuta komunikim thirrje telefonike në muaj dhe ka dërguar 21 SMS në muaj. Nëse do i referoheshim konsumit mesatar për një përdorues aktivë, këto vlera janë shumë më të mëdha: 319 minuta komunikim thirrje telefonike në muaj dhe 35 SMS në muaj.

AKEP gjykon se minutat reale të përdorimit mesatar janë më afer treguesve të matur me përdorues aktivë, pasi një numër i konsiderueshëm pajtimtarësh të kartave SIM janë vetëm përdorues sezonalë apo sporadikë (emigrantë, vizitorët që përdorin karka SIM të operatorëve celularë Shqiptarë gjatë qëndrimit të përkohëshëm apo vizitave në Shqipëri).

### **Portabiliteti**

Në vitin 2012, portabiliteti i numrit tregoi se ishte një masë rregullatore e suksesshme. Sasia e numrave të celularëve të bartur në vitin 2012, ka qënë rreth 2.5 herë më lartë krahasuar me një vit më parë dhe ka arritur në një shifër prej 136998 në total. Rritja e konkurrencës efektive ka bërë që në treg të vazhdojnë të hidhen oferta dhe plane tarifore të reja me përfitim për konsumatorin. Përdoruesit vazhdojnë të tregohen aktivë duke zgjedhur rrjetin dhe planet tarifore nga të cilat përfitojnë dhe që u përshtaten më mire kërkesave personale. Numri i përdoruesve të cilat kanë përfituar nga planet e reja tarifore është disa herë më i madh se numri i bartjeve.

Koha mesatare që i duhet një pajtimtari për të bartur numrin, nga momenti i dërgimit të kërkesës deri në marrjen e shërbimit nga operatori i ri është 1.6 ditë, ndërsa koha mesatare që abonentët ngelen pa shërbim është rreth 75 minuta.

### **Tarifat celulare**

Gjatë vitit 2012, ka vazhduar tendenca e reduktimit të tarifave të shërbimeve celulare që ka ardhur si pasojë e rritjes së mëtejshme të konkurrencës në treg. Në këto reduktime të tarifave kanë luajtur rol të rëndësishëm vazhdimi i reduktimit të tarifave të terminimit midis operatorëve si dhe efekti pozitiv i procesit të bartjes së numrit celular.


Në figurat e mëposhtme paraqitet ecuria e tarifave celulare e matur me shpenzimet për shportat OECD dhe krahasimi me rajonin dhe mesataren e BE, sipas publikimit të Cullen International në Korrik 2012. Nga ecuria dhe krahasimi rezulton se shpenzimet janë kryesisht sa niveli mesatar në vendet e BE ose më të ulëta. Krahasimi i shpenzimeve të



këtyre shportave në Nëntor 2012 me Nëntor 2011 tregon se në vitin 2012, tarifat e matura me shpenzimet për shportat OECD janë reduktuar mesatarisht me 8% dhe;

- ♦ Shporta Low Usage: reduktim mesatarisht me 5%
- ♦ Shporta Medium Usage: reduktim mesatarisht me 14%
- ♦ Shporta High Usage: reduktim mesatarisht me 6%.


**Figura 9: Shpenzimet për shportat OECD (të dhëna nga raporti i Korrik 2012 i Cullen International)**



Ndërkohë në figurat e mëposhtme paraqitet krahasimi i dy treguesve të tjerë me vendet e rajonit dhe të BE.

- Cmimi mesatar për minute (Average Price Për Minute-APPM) e matur si raporti i të ardhurave të operatorëve nga shërbimet telefonike zanore me pakicë (përfshirë pagesat fikse) me numrin total të minutave dalëse. Ky tregues për Shqipërinë është dy herë më i ulët se mesatarja e vendeve të BE dhe ndër më të ulëtat në rajon.
- E ardhura mesatare për përdorues (Average Revenue Për User-ARPU)<sup>3</sup>, e matur si raporti i të ardhurave të operatoreve nga shërbimet me pakicë pa TVSH (pa përfshirë të ardhurat nga shitja e aparateve celulare)<sup>4</sup> të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve gjatë një viti. Ky tregues për Shqipërinë në vitin 2011 ishte 59 Euro nëse do ti referoheshim vetëm përdoruesve aktivë celularë dhe 38 euro/vit nëse do ti referoheshim kartave SIM aktive. Në të dy rastet ARPU në Shqipëri është shumë më ulët se mesatarja e BE prej 221 euro/vit më të ulët në BE (Rumania me 90 Euro).

**Figura 10: Cmimi mesatar për minutë të thirrjeve dalëse celulare (Euro për minute pa TVSH) për vitin 2011**




**Burimi: Cullen International Korrik 2012**

<sup>3</sup> Të dhënat në këtë raport/figure për ARPU nuk janë të krahasueshme me vitet e mëparshme për shkak të mënyrës së ndryshme të matjes nga EC. Më të njëjtën metodë si në vitet e mëparshme ARPU për Shqipërinë në 2011 ishte 57 euro në vit në krahasime me 70 euro/vit për 2011.

<sup>4</sup> Për Shqipërinë përfshihen të gjitha të ardhurat nga shërbimet me pakicë, pra dhe nga aparatet celulare, megjithatë ky zë konsiderohet shumë i vogël për Shqipërinë.

**Figura 11: ARPU Celular (Euro/vit pa TVSH) BE 2010/Shqiperi 2011**




Burimi: EC Electronic Communications Market Indicators dhe AKEP

### 2.1.2 Telefonia fikse

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2012 pati rënie me rreth 27000 apo 8% në krahasim me vitin 2011. Rënia ka ardhur për shkak të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Altelecom me rreth 29 mijë ndërsa numri i pajtimtarëve të operatorëve alternative nuk ka pasur ndryshime të ndjeshme. Tendenca në ulje e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse duket se po ndjek atë të vendeve të BE, megjithatë norma e penetrimit të telefonise fikse (11%) në Shqiperi vazhdon të jetë shumë e ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej 40%) dhe vendet e rajonit.

Numri i pajtimtarëve të Altelecom ka vazhduar të reduktohet si edhe në dy vitet e mëparshme 2010 dhe 2011, por me një reduktim edhe më të madh. Figura e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe Altelecom dhe operatorëve alternativë.

**Figura 12. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2012**




Numri total i pajtimtarëve të operatorëve alternative nuk ka pasur ndryshime të ndjeshme nga viti 2011. Ndër operatorët alternativë kryesorë rritje kane pasur ABCom dhe Nisatel me 21% dhe 11% respektivisht. Ndërsa operatorët e tjerë si AMC (AMC fiks), Primo dhe ASC kanë pasur rënie me 19%-24% të numrit të pajtimtarëve në 2012 në krahasim me 2011. Rënia e numrit të pajtimtarëve të Altelecom ka cuar në reduktimin e pjesës së tregut të Altelecom nga 76% në 2011 (84% në 2010) në 74% në 2012. Operatorët alternativë nuk kanë ndryshime në pjesët e tregut, përveç ABCom që ka rritur pjesën e tregut nga 8% në 2011 në 11% në 2012.

**Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse sipas operatorëve (2011-2012)**

	Altelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Primo	AMC Fiks	OA te tjere	Total
<b>2012</b>	230,397	33,000	7,649	5,500	<b>2,584</b>	<b>6,119</b>	26,412	311,661
<b>2011</b>	258,943	27,167	10,129	4,950	3,300	7,565	26,790	338,844
<b>2010</b>	<b>277,763</b>	<b>19,975</b>	<b>7,408</b>	<b>5,900</b>	<b>3,678</b>	-	<b>16,778</b>	<b>331,502</b>
<b>Ndryshimi 2012/2011</b>	-11%	21%	-24%	11%	-22%	-19%	-1%	-8%

**Figura 13: Pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2012)**



### **Tarifat e telefonisë fikse**

Për sa i përket tarifave të telefonisë fikse, Altelecom nuk ka pasur ndryshime të tarifave të paketave standarde “Familjare” dhe “Të tjerë”. Gjatë vitit 2012, Altelecom ka vazhduar hedhjen në treg të paketave të reja tarifore me zgjedhje për pajtimtarët “Familjare” të tilla si FolFix 1000 dhe FolFix 1500 si dhe paketa të kombinuara: telefoni dhe akses në Internet si iFiks. Këto paketa janë fokusuar në ofrimin e shportave të thirrjeve me një tarifë fikse (pajtim mujor plus thirrje telefonike) si dhe në ofrime të shportave të kombinuara të telefonisë fikse (pajtim mujor plus thirrje) dhe akses në Internet me tarife fikse. Këto paketa vihet re se janë me atraktive se paketa standard për përdoruesit fundorë pasi janë përzgjedhur nga rreth 30% e pajtimtarëve “Familjare”. Gjatë tremujorit të katërt 2012, Altelecom ka filluar të ofrojë paketa të kombinuara (telefoni dhe Internet) edhe për pajtimtarët “Biznes”.

Paketat tarifore të konkurrenteve kryesorë të Altelecom në telefoninë fikse përmbajnë paketa me pajtim mujor të ulët si dhe me tarifa të uleta brënda rrjetit si edhe paketa të integruara të telefonisë, Internet dhe televizion në disa raste.

Përfshirja në paketat e shërbimeve telefonike e shërbimit të aksesit në Internet nga Altelecom dhe nga operatorë alternative, dhe përzgjedhja e tyre nga një numër i madh pajtimtarësh tregon se konkurrenca midis operatorëve të telefonisë fikse tashmë nuk është vetëm në drejtim të shërbimeve telefonike por edhe në shërbimin e Internetit. Evolimi i teknologjisë dhe sjelljes konsumatore në drejtim të paketave të integruara dhe të thjeshta (me përfshirje të minutave në pagesë mujore) dhe rritja e kërkesës për akses në Internet, kane bërë që shtytesi kryesor për zhvillimin e telefonisë fikse të jetë aksesit broadband në internet (operatorët alternative që kanë përfutuar abonentë janë edhe ISP më të mëdha në vend).

### 2.1.3. Interneti

Numri pajtimtareve me akses broadband fikse dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2012 arriti në rreth 215 mijë që përbeën një rritje me rreth 24% në krahasim me vitin 2011. Numri i pajtimtarëve me akses broadband me rrjete fikse pati një rritje prej 15%, ku shumica e operatorëve kanë pasur rritje të numrit të pajtimtarëve, përfshirë edhe Albtelecom që pati një rënie në 2011. Albtelecom në 2012, pati rritje me 11% të numrit të pajtimtarëve broadband. Ndër operatorët alternativë fikse ABCOM vazhdon të jete operatori me numrin më të madh të lidhjeve broadband me rreth 36 mijë në fund të vitit 2012, që përbën një rritje prej 22% nga viti 2011. Rritje të madhe kanë pasur edhe Abissnet dhe ASC si dy operatorët e tjerë alternative më të mëdhenj me 16% secili.

Numri i pajtimtarëve me akses broadband celular (3G me karta USB/modem për përdorim me kompjuter) në fund të 2012, arriti në 55 mijë nga 34 mijë në fund të 2011, që përbën një rritje me 61%. Të dy operatorët celularë Vodafone dhe AMC, kanë pasur rritje të ndjeshme me 47% dhe 98% respektivisht. Rritje të madhe me 139% pati edhe numri i përdoruesve me akses broadband 3G nga aparatet celulare, duke arritur në fund të 2012, në 594 mijë nga 248 mijë në fund të 2011. Numri i përdoruesve celulare që përdorin internetin GPRS/EDGE (2.5 G) në 2012 arriti në rreth 1.4 milion nga 1.2 milion në 2011, që përbën një rritje me 15%.

	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA te tjere	Total Fiks	AMC	Vodafone	Total Fiks +3G
<b>2010</b>	<b>70,597</b>	<b>13,575</b>	<b>7,000</b>	<b>5,666</b>	23,162	120,000			
<b>2011</b>	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697	9,000	25,493	174,190
<b>2012</b>	66,757	<b>35,870</b>	<b>17,719</b>	11,777	27,965	160,088	17,833	37,572	215,493
<b>Ndryshimi 2012/2011</b>	11%	22%	16%	16%	12%	15%	98%	47%	24%


Pjesët e tregut në vitin 2012, nuk kanë ndryshime të ndjeshme me ato të vitit 2011. Albtelecom ka humbur pjesë tregu në aksesin broadband fikse nga 43% në 2011 (58% në 2010) në 42% në 2012. Operatorët e tjerë kane shtime të vogla në pjesët e tregut në krahasim me shtimin në 2011.

### **Tarifat e aksesit broadband**

Figura e mëposhtme paraqet krahasimin e tarifave të aksesit broadband në Internet, për shpejtësi të ndryshme (pa limit download), me vendet e rajonit, ku vihet re se tarifat në Shqipëri janë në nivelin mesatar të vendeve të rajonit, për operatorin inkumbent dhe operatorët alternativë.



**Figura 14: Krahasimi i tarifave të aksesit broadband pa limit me vendet e rajonit**



*Burimi: Cullen International Korrik 2012*

Niveli i tarifave të paraqitur në figurë është i Marsit 2012. Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimin e tarifave të aksesit broadband të Altelecom në periudhen 2011 deri në Tetor 2012. Nga tabela vihet re se reduktimet variojnë nga 20 deri në 56%.

**Tabela 7: Ndryshimi i tarifave të aksesit broadband ADSL të Altelecom (2011-2012)**

Paketa	2Mbps/256kbps ADSL Unlimited	4Mbps/512kbps, ADSL unlimited	8Mbps/768kbps,	12 Mbps/1Mbps unlimited Static IP
<b>2011</b>	2499	3999	8999	9999
<b>2012</b>	1999	2999	3999	7499
<b>Ndryshimi</b>	<b>-20%</b>	<b>-25%</b>	<b>-56%</b>	<b>-25%</b>

Njëkohësisht gjatë vitit 2012 është vënë re se Altelecom ka ofruar rritje (dyfishim) të kapacitetit download për paketat 2Mbps/256kbps ADSL të limituar si dhe për paketat 2 Mbps dhe 4 Mbps ka ofruar paketa të integruara (i-Fiks) duke përfshirë në çmimet e mësipërme edhe pajtimin mujor telefonik dhe 1000-1500 minuta thirrje telefonike.

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

[www.akep.al](http://www.akep.al)

Faks : + 355 4 2259 106

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

Operatorët alternativë kanë qënë gjithashtu aktivë në reduktimin e tarifave të aksesit në Internet dhe tarifat e tyre janë të krahasueshme me ato të Albtelecom, dhe siç është theksuar më sipër, operatorët kryesorë alternative ofrojnë edhe paketa të kombinuara telefoni, Internet dhe television në disa raste.

## **2.2 Analizat e Tregjeve**

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918, dhe Rregullores “Per Analizën e Tregut”, miratuar nga AKEP, me VKD nr.747 datë.17.07.2009, gjatë vitit 2012, nxorri për konsultim publik dhe miratoi versionin final të analizës së tregut të telefonisë celulare dhe vendimet për Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT), si edhe kreu konsultimin publik për analizën e tregut të telefonisë fikse.

### **2.2.1 Procesi i analizave të tregjeve gjatë vitit 2012:**

#### **Analiza e tregut celular**

Më 20.04.2012-20.06.2012 AKEP kreu konsultimin publik për analizën e tregjeve nr.16 dhe nr.17 të Rregullores për:

- 1) Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme;
- 2) Tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike të lëvizshme

Më 4.07.2012, AKEP miratoi versionin final të analizës dhe me Vendimet 2119-2122, datë 4.07.2012, përcaktoi AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication sipërmarrës me FNT për tregjet përkatës të mëposhtëm:

- AMC sh.a sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular AMC.
- Vodafone Albania sh.a sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Vodafone Albania.
- Eagle Mobile sh.a sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Eagle Mobile.
- Plus Communication sh.a sipërmarrës me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Plus Communication.

Nëpërmjet vendimeve të mësipërme u përcaktuan edhe masat rregulluese për secilin sipërmarrës që përfshijnë:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit, përfshirë publikimin e ofertës referencë të interkoeksionit (neni 39)
- Detyrimi i transparencës (Neni 40)
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
- Detyrimi për ndarjen e llogarive (neni 41)
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Në lidhje me tarifat e terminimit të thirrjeve në secilin prej rrjeteve celulare, AKEP vendosi rregullimin e tyre për orientim në kostot BULRAIC, sipas skemës dhe niveleve të përcaktuara në VKD 1506, 1507 dhe 1508 datë 10.02.2011 për AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile (tabela me poshtë), ndërsa për Plus Communication u vendos

reduktimi i tarifës së terminimit por me një përshkallëzim më të zbutur se ai i propozuar në Shkurt 2011, për shkak të kushteve më të vështira të konkurrencës për hyrësin e ri në treg.

**Tabela 8: Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të terminimit në rrjetet celulare për orientim në kosto sipas BU-LRAIC (lekë/minute)**

	2010-28.02.2011	1.03.2011-31.08.2011	1.09.2011-31.08.2012	1.09.2012-31.08.2013	1.09.2013-31.08.2014	1.09.2014-31.08.2015	1.09.2015-
<b>AMC, Vodafone</b>	10.5	8.85	7.57	6.10	4.57	4.57	4.57
<b>Eagle Mobile</b>	12.92	10.89	8.85	6.52	4.57	4.57	4.57
<b>Plus Communications</b>	18.9	18.9	18.9	12.92	8.85	6.52	4.57

*Tarifat e mësipërme nuk përfshijnë TVSH.*

Për sa i përket tregut të akses dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare, AKEP arriti në përfundimin se ky treg nuk është më i justifikuar për ndërhyrje ex-ante, duke vendosur heqjen e statusit dhe detyrimeve të FNT për AMC dhe Vodafone Albania të percaktuara në 2010. Ndër arsyt kryesore të arritjes në këtë përfundim ishin rritja e ndjeshme e konkurrencës në tregun me pakicë celular në periudhen 2010-2012 dhe pritshmëritë për konkurrencë më të madhe në vitet në vijim si dhe mosplotësimi i testit të tre kritereve për treg përkatës të justifikuar për ndërhyrje ex-ante.

#### **Analiza e tregut të telefonisë fikse**

Më 3.08.2012-3.10.2012 AKEP kreu konsultimin publik për dokumentin e analizës së tregut të telefonisë fikse, që përmban analizën e tregjeve me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjeve me shumicë të interkoneksionit në rrjetet fikse (origjinim, terminim dhe tranzitim), dhe konkretisht:

- 1) Tregu me pakicë i aksesit në rrjet publik telefonik nga vendndodhje fikse (*për pajtimtarë familjarë dhe jo –familjarë*);
- 2) Tregu me pakicë i thirrjeve telefonike të disponueshme për publikun nga vendndodhje fikse (*për pajtimtarë familjarë dhe jo –familjarë*);
- 3) Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse;
- 4) Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse;
- 5) Tregu me shumicë i shërbimeve transite në rrjetet telefonike publike fikse.

Tregjet përkatës me shumicë janë të njëjta me ato të analizuara më parë nga AKEP në 2010, ndërsa tregjet me pakicë janë ri-segmentuar në dy tregje, por përsëri përmbajnë të njëjtat shërbime si të gjashtë tregjet e përkufizuar në 2010.

AKEP është në proces diskutimi të versionit final të këtij dokumenti analize dhe vendimeve përkatëse për FNT dhe masat rregulluese përkatëse.

## **2.3. Masat rregullatore**

### **2.3.1 Zgjedhja dhe Parazgjedhja e bartësit**

AKEP me VKD nr.1778, datë 20.02.2012, miratoi tarifat e Altelecom për ofrimin e shërbimeve të Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit të thirrjeve si dhe përfshirjen e tyre në ofertën referencë të interkoneksionit të Altelecom. Ky vendim ishte në vijim të miratimit në 2011 nga AKEP të Rregullores dhe Udhëzimit për implementimin e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit të thirrjeve. Këto shërbime i krijojnë mundësinë përdoruesve fundorë të Altelecom që duke përdorur linjën telefonike të Altelecom (ofruesi i aksesit), të zgjedhin vetë ofruesin e thirrjeve telefonike që i konsiderojnë më të mirat për nevojat e tyre, veçanërisht për sa i përket çmimit dhe cilësisë së thirrjeve telefonike. Operatorët e tjerë të shërbimeve telefonike, duke përdorur linjën telefonike të Altelecom, u ofrojnë përdoruesve të Altelecom thirrje telefonike. Në këtë mënyrë krijohet mundësia për një konkurrencë më të madhe midis operatorëve në ofrimin e thirrjeve telefonike duke rritur përfitimet e përdoruesve fundorë për tarifa më të lira për thirrjet telefonike.

### **2.3.2. Implementimi i LLU**

Në vijim të proceseve të implementimit të LLU (Local Loop Unbundling- Hapja e Qarkut Lokal) në 2011, AKEP më datë 31.05.2012 me VKD nr.1975, miratoi ofertën referencë të aksesit të hapur në qarkun lokal (RUO) të Altelecom. Nëpërmjet vendim-marrjes AKEP imponoi ndryshime të rëndësishme në dokumnetin e propozuar nga Altelecom sidomos reduktime të ndjeshme të tarifave të propozuara nga Altelecom. Oferta referencë (RUO) u publikua nga Altelecom dhe shërbimet e LLU (Local Loop Unbundling) kanë qënë të diponueshme për operatorët që në Qeshor 2012. RUO përmban detyrimet e Altelecom (rregullat, procedurat, afatet dhe tarifat) për të ofruar akses operatorëve të tjerë në rrjetin e tij lokal të linjave telefonike të pajtimtarëve, në mënyrë që pajtimtarët e tij të kenë mundësinë të përfitojnë shërbimin e aksesit në Internet broadband dhe thirrje telefonike, nga operatorët e tjerë. Këto shërbime krijojnë mundësinë operatorëve të tjerë që të ofrojnë shërbime akses në Internet pa qënë nevoja të ndërtojnë linja direkte fizike për përdoruesit fundorë, por të shfrytëzojnë linjat e Altelecom për këto shërbime.

Megjithë implementimin e këtyre masave rregullatore, vihet re se operatorët nuk kanë treguar interes për LLU dhe për Zgjedhjen dhe Parazgjedhjen e Bartësit të thirrjeve. Kjo mund të shpjegohet me disa arsye të tilla si: ekzistenca e një numri të madh operatorësh të rrjeteve fikse (rreth 80) që kanë rrjetin e vet të fibrave dhe linjave të veta fundore, nivelin e ulët të penetrimit të telefonise fikse si dhe procesi i migrimit të rrjetit të Altelecom nga PSTN/TDM në NGN/NGA. Përsa i përket Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes

së Bartësit, vihet re se në Shqipëri ofrimi i thirrjeve telefonike me karta me parapagim (prepaid calling cards) nga operatorët alternativë është formë e preferuar për këta operatorë.

### **Ofertat Rerence të Interkoneksionit**

Në vijim të Vendimeve 2119-2122, datë 4.07.2012, për përcaktimin me FNT të katër operatorëve celularë dhe vendosjen e masave rregulluese për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, AKEP me VKD nr.2176-2179, datë 29.10.2012 miratoi ofertat referencë të interkoneksionit të katër operatorëve celularë.

### **Orientimi në kosto dhe detyrimet për AS/CA**

Në Shtator 2012 u implemtua faza e tretë e reduktimit të përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare për orientimin në kosto të tyre sipas vlerave të miratuara në Shkurt 2011 nga AKEP dhe të dhëna në Tabelen 8.

Në vijim të vendimeve nr.1710-1713, datë 31.03.2011 për përcaktimin me FNT të katër operatorëve celularë për terminimin e SMS-ve në rrjetet e tyre dhe masat rregulluese për FNT, gjatë vitit 2012, me 1.01.2012 dhe 1.09.2012, u implementuan faza e parë dhe e dytë e reduktimit të tarifave të terminimit të SMS-ve, duke reduktuar këto tarifa nga 3 lek/SMS në 2 lek/SMS.

Më datë 29.02.2012, AKEP bazuar në procesin e migrimit të rrjetit të Albtelecom nga rrjet tradicional PSTN/TDM në NGN/NGA, i kërkoi Albtelecom që të përlloragiste kostot e shërbimeve bazuar në kushtet e reja të rrjetit të tij dhe të tregut. Albtelecom më 5.11.2012 depozitoi në AKEP dokumentin e përlloragitjes së kostove të Albtelecom, të kryera me konsulencë ndërkombëtare nga ky i fundit. AKEP ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës dhe është në proces të verifikimit të tyre.

Në vijim të detyrimeve të vendosura për sipërmarrësit me FNT (operatorët celularë dhe Albtelecom) për ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (AS/CA-Account Separation/Cost Accounting), AKEP gjatë vitit 2012, përgatiti termat e referencës për konsulencë ndërkombëtare për hartimin e rregullave dhe udhëzimeve për AS/CA, dhe më 19.11.2012, publikoi dokumentin e tenderit për konsulencë ndërkombëtare për këtë shërbim. Tenderi është në proces dhe pritet që në muajin Mars 2013 të kryhet përzgjedhja e fituesit.

## **2.4 Rregullimi i Tregut Postar**

Në bazë të ligjit 9918, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar me ligjin nr. 10132, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, funksionet rregullatore për sektorin postar i kryhen AKEP.

Si në tre vitet e mëparshme edhe në vitin 2012, çështjet rregullatore të sektorit postar, në mungesë të strukturës me persona të specializuar për shërbimet postare, janë ndjekur nëpërmjet grupeve të punës të ngritur me urdhër të Kryetarit. AKEP në vitin 2012, ka punuar për krijimin e kuadrit rregullator të domosdoshem, pavaresisht se politika

sektoriale dhe legjislatoni për sektorin postar nuk i përgjigjen ndryshimeve dhe zhvillimeve që ka pësuar sektori.

Në bazë të dispozitave të Rregullore nr. 21 datë 18.03.2011, “Për Licensën e Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare”, në vitin 2012, është licencuar një ofrues i shërbimeve postare dhe në regjistrin e subjekteve që ofrojnë shërbime postare rezultojnë:

- 1- operator publik postar (Posta Shqiptare sh.a); dhe
- 11- ofrues të shërbimeve postare

Me qëllim grumbullimin, evidentimin dhe përdorimin e të dhënave statistikore dhe financiare mbi shërbimet postare, për të nxjerrë përfundimet e nevojshme për analizën dhe tendencat e zhvillimit të tregut postar si dhe përcaktimin e masave përkatëse me VKD Nr. 2231, datë 28.12.2012, është miratuar Rregullore nr. 28, datë 28.12.2012 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”.

Në këtë rregullore përcaktohet se operatori/ofruesi i shërbimeve postare është i detyruar të plotesoje dhe dërgoje *on line* formularët me të dhënat e kërkuara brënda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, për këtë arsye, dhe meqënëse nuk janë mbledhur më parë të dhëna nga AKEP, në këtë raport nuk mund të jepet një panoramë e tregut postar në vend.

### **3. Veprimtaria e rregullimit teknik**

Në vitin 2012, puna për rregullimin në aspektin teknik të tregut, është fokusuar në tre drejtimet bazë të viteve të fundit dhe konkretisht:

- i. Administrimin me efektivitet të spektrit të frekuencave;
- ii. Miratimin e standardeve dhe treguesve të cilësisë së shërbimit;
- iii. Administrimin dhe liberalizimin e vazhdueshëm të domain-eve nën.al

#### **3.1.Administrimin me efektivitet i spektrit të frekuencave**

Administrimi me efektivitet i spektrit të frekuencave realizohet me zbatimin me korrektesi të Planit Kombëtar të Frekuencave (PKF), dhe politikave sektoriale, këto në koherencë me vendimet, rekomandimet dhe raportet e ECC (ECO-European Communication Office) dhe ITU (International Telecommunication Union) lidhur me përdorimin e koordinuar të spektrit të radiofrekuencave.

#### **- Dhënia e autorizimit të tretë për përdorimin e frekuencave për ofrim shërbimesh të stadardit 3G.**

Në fund të vitit 2011 dhe fillim të vitit 2012, AKEP nisi procedurën për dhënien e së drejtës të tretë të frekuencave 1900/2100 MHz për ofrimin e shërbimeve 3G, dhe në ditën e paraqitjes së ofertave me 24.02.2012, morën pjesë në procedurë dy operatorë celularë (Eagle Mobile dhe Plus Communication), por me oferta më të vogla se cmimi më i ulët i pranueshëm, duke bërë që procedura të anulohet.

Duke marrë parasysh mosrealizimin e tenderit për dhënien e autorizimit të tretë për këtë brez frekuencash, AKEP me date 30.05.2012, hapi procesin e këshillimit publik për të

tërhequr opinion e tregut mbi cmimin dhe numrin e të drejtave që do të jepen gjatë procesit të rradhës.

Bazuar në rezultatet e këshillimit publik në lidhje me interesin mbi dy të drejta përdorimi të spektrit ku mbështetet teknologjia për shërbime 3G, AKEP më datë 10.10.2012 zhvilloi tenderin me procedure të hapur për dhënien e njëkohëshme të dy të drejtave të përdorimit të frekuencave. Në këtë proces rezultoi se vetëm oferta e “Eagle Mobile” sh.a me vlerë 4 000 355 Euro ishte e vlefshme ndërsa oferta tjetër ishte nën cmim minimal të pranueshëm të caktuar në dokumentacion. Më datë 17.12.2012 sipërmarrësit “Eagle Mobile” iu lëshua autorizimi për përdorimin e frekuencave ku mbështetet teknologjia që ofron shërbime të standardit 3G, duke u bërë operator i tretë në vend që ofron shërbime të këtij standardi.

**- Dhënia e autorizimeve për përdorim frekuencave nga sipërmarrësit dhe subjektet.**

Gjatë vitit 2012, bazuar në kërkesat e sipërmarrësve për ofrim rrjeti/shërbimesh të komunikimeve elektronike ose për nevoja të vet subjekteve, në zbatim të Planit Kombëtar të Frekuencave si dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave AKEP ka lëshuar:

- 25 autorizime individuale për sipërmarrësit e telefonisë së lëvizshme, për përdorimin e frekuencave, në 615 lidhje fikse radio të reja, 320 lidhje fikse të ndryshuara;
- 25 autorizime individuale për përdorim të frekuencave në 46 lidhje fikse radio për sipërmarrësit e tjerë;
- 6 autorizime individuale për përdorim të frekuencave në 8 lidhje fikse radio, për subjektet Radio Televizive;
- 3 autorizime individuale për përdorim të frekuencave në 3 sisteme satelitore;
- 80 autorizime individuale për përdorim të frekuencave në 110 sisteme radiokomunikimi dhe 57 sisteme radioalarmi.

Për menaxhim me efektivitet të spektrit, me nisme të vet, AKEP ka bërë 39 revokime autorizimesh të subjekteve që përdorin sisteme radio të lëvizshme. Revokimet janë bërë për arsye të mospagesës ose për pajisje fiktive me autorizim për përdorim të frekuencave, vetëm për qëllim pjesëmarrje në tender. Lista e revokimeve është publikuar në faqen e Internetit të AKEP.

**- Studimi i brezave VHF/UHF**

Kërkesat për shpejtësi të larta në transmetimin e informacionit në sektorin e komunikimeve elektronike dhe futja e teknologjive të reja për aplikimet me brez të gjerë (broadband), kërkojnë planifikim dhe përdorim më efektiv të të gjithë spektrit të frekuencave radio. Këto kërkesa për frekuenca radio sot, por më shumë në të ardhmen, paraqiten nga të dy shërbimet, civil dhe ushtarak.

Gjithashtu, konvergjenca e përdorimit të spektrit të frekuencave radio për transmetimet televizive dhe telekomunikacion, si rezultat i dixhitalizimit, dikton përdorimin më fleksibël të spektrit të frekuencave radio.

Për këtë arsye, AKEP ka përgatitur studimin e brezave VHF/UHF në bashkëpunim me institucionet e tjera. Përdorimi i këtyre brezave të frekuencave radio, në Republikën e Shqipërisë, është bazuar në raportin ERC Report 25 - Tabela Europiane e Përcaktimit dhe

Përdorimit të frekuencave në Brezin 9 kHz deri 3000 GHz – ECA (*European Table of Frequency Allocations and Utilisations in the frequency range 9 kHz to 3000 GHz*).

Ky studim do të bëhet efektiv në hartimin e Planit të ri të Përdorimit, pas miratimit të ndryshimeve në planin ECA (përfshirjes së vendimeve të WRC-12- Konferencës Botërore të Radiokomunikacionit-2012) dhe implementimit të tyre në PKF.

Pas miratimit të ndryshimeve në ECA plan (përfshirjes së vendimeve të WRC-12) dhe implementimit të tyre në PKRF tonë, ky studim do të bëhet efektiv për hartimin e Planit të ri të Përdorimit.

**- Marrëveshjet me institucionet në vend dhe autoritetet rregullatore të vendeve fqinje.**

AKEP, bazuar në ligjin 9918, ka nënshkruar marrëveshje teknike me Ministrinë e Brëndshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me planifikimin e brezit të frekuencave që përdoret në sistemet dhe rrjetet e transmetimit radio të këtyre institucioneve shtetërore.

Qëllimi i këtyre marrëveshjeve teknike është që, bazuar në Nenin 62 dhe 64, të ligjit 9918 dhe PKF, të përcaktojë Planin e Frekuencave Radio që keto institucione do të kenë në dispozicion, për ta përdorur në sistemet dhe rrjetet radio. Gjithashtu këto marrëveshje forcojnë bashkëpunimin institucional për administrimin më të mirë të spektrit të frekuencave radio dhe rritjen e efektivitetin të përdorimit të tij, shmangien e interferencave të dëmshme në sistemet dhe rrjetet e shërbimit radio dhe plotësimin e kërkesave të institucioneve për breza të tjerë frekuencash për nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Realizimi i tyre ka ardhur nëpërmjet një procesi të gjatë konsultimi dhe diskutimesh mes palëve.

Me qëllim parandalimin e interferencave reciproke në rrjetet e shërbimit fiks radio dhe të lëvizshëm telefonik tokësor dhe përdorimin sa më optimal të spektrit radio GSM 900 MHz dhe GSM 1800 MHz, nga operatorët që operojnë në zonat kufitare midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje, AKEP ka iniciuar procedurat për nënshkrimin e marrëveshjeve me autoritetet rregullatore të Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Greqisë. Në marrëveshje përcaktohen rregullat administrative dhe procedurat teknike për planifikimin dhe koordinimin e frekuencave, me qëllim parandalimin e interferencave reciproke.

Pjesë e procesit të arritjes së marrëveshjeve janë të gjitha palët e interesuara veçanërisht operatorët e telefonisë së lëvizshme përdorues të këtyre brezave të frekuencave, të cilët kontribuojnë në proces.

### **3.2 Miratimi i standardeve dhe treguesve të cilësisë së shërbimit**

- Me hyrjen në fuqi të Vendimit Nr.331, datë 14.4.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve””, AKEP miratoi Rregulloren “Për Njohjen e Konformitetit”.

Bazuar në këtë rregullore, me hartimin dhe publikimin e listës së pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve të cilat nuk duhet të njoftohen për të kaluar



në procedurën e njohjes së konformitetit si dhe listës së pajisjeve që kanë kaluar në procedurën e njohjes së konformitetit duke filluar nga viti 1999 dhe deri më sot, procesi i njohjes së konformitetit është i thjeshtë dhe transparent.

- Me VKD nr. 2230, datë 28.12.2012, Rregullores nr. 16, datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit” iu shtua Aneksi IV: Treguesit e cilësisë së shërbimit (QoS) dhe indikatorët e performancës për aksesin në rrjetet telefonike publike tokësore të lëvizshme (plmn) për monitorim.  
Me kete dokument percaktohen standardet e cilesisë së shërbimit për monitorim, për operatorët celularë. Gjithashtu, siç është përmendur, u krye monitorimi i mbulimit me sinjal dhe treguesve të cilësisë për shërbimet GSM/UMTS në të gjithë rrugët nacionale. Raporti i plotë i monitorimit iu dërgua operatorëve përkatës, ku u kërkua marrja e masave për përmirësim të cilësisë së shërbimit dhe mbulimin e disa segmenteve rrugore të pambuluar.

### 3.3 Administrimi dhe liberalizimi i vazhdueshëm i domain-eve nën.al

Për administrimin dhe liberalizimin e regjistrimit të domain-eve nën.al, krahas menaxhimit të sistemit në operim, në vitin 2012, përfundoi dhe ngritja e sistemit automatik të menaxhimit “Registry/Registrar”. Ky sistem është i bazuar i gjithi mbi platforma *on line*, që mundëson automatizimin e plotë të procesit që nga aplikimi deri në posedim domain-i dhe liberalizimin e plotë të regjistrimit të domain nën.al.

Për liberalizimin e plotë të regjistrimit, krahas plotësimit të kriterit teknologjik, duhet plotesimi i kriterit rregullator. Për këtë, në vitin 2012, u hartua dhe u nxorr për këshillim publik dokumenti me disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, datë 21.2.2008 “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”. Ndryshimet dhe shtesat reflektojnë standardet e vendosura nga organizata botërore e administrimit të Internetit ICANN. Ecuria e regjistrimit të domain-eve nën.al në vite jepet në tabelën e mëposhtme.

Domain	Numri i domain-eve të regjistruar, 1998-2009	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2010	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2011	Numri i domain-eve të regjistruar ne total
.al	1182	3912	6200	8334
.com.al	309	435	544	630
.gov.al	160	192	273	301
.org.al	93	93	116	134
.edu.al	75	81	124	133
.net.al	12	18	23	28
.mil.al	8	8	8	8
<b>Total</b>	<b>1893</b>	<b>4793</b>	<b>7387</b>	<b>9668</b>

Liberalizimi i procedurës së regjistrimit do të bëjë më tërheqës domain-et nën zonën .al. Për vitin 2012, numri i domain-eve të regjistruar është 2281.

#### **4. Veprimtaria monitoruese dhe inspektuese**

##### **4.1 Veprimtaria monitoruese**

Gjatë vitit 2012, me prokurimin e Qendrës së Testimit të Rrjeteve të Transmetimit GSM, UMTS, LTE, etj qëllimi i veprimtarisë monitoruese nuk ka qënë vetëm eliminimi i interferencave dhe evidentimi i mbulimit me sinjal, por edhe treguesit e cilësisë të ofruar për zonat e mbulimit.

- i. Në periudhën qershor-korrik 2012, u krye monitorimi i mbulimit me sinjal dhe treguesve të cilësisë për shërbimet GSM/UMTS në të gjithë rruget nacionale. Raporti i plotë i monitorimit iu dergua operatorëve përkatës, ku u kërkua marrja e masave për përmirësim të cilësisë së shërbimit dhe mbulimin e disa segmenteve rrugore të pambuluar. Nga operatorët janë dorëzuar në AKEP planet e masave për mbulim/përmirësimin e mbulimit për vitin 2013.
- ii. Për periudhën në raportim janë kryer matje monitoruese në 13 pika kryesore transmetuese të vendit. Qëllimi i këtij monitorimi ka qënë konstatimi i devijimeve të mundshme nga kushtet e autorizimeve individuale dhe menaxhimi me efektivitetin e spektrit të frekuencave. Kjo detyrë u realizua në bashkëpunim me sektorin e menaxhimit të spektrit për të mbajtur të përditësuar bazën e të dhënave të menaxhimit të frekuencave. Ky proces do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2013.
- iii. Me implementimin e teknologjive që mbështesin shërbimet e standardit 3G, janë konstatuar probleme të interferencave të shfaqura në operatorët që ofrojnë shërbimin e telefonisë së lëvizshme dhe operatorët e rrjeteve private të radiokomunikacionit në qytetet Tiranë, Elbasan, Fier, Kavajë, Vlorë, Lushnje, Kukës. Gjithashtu me përparësi të veçantë janë trajtuar ankesat e Agjensia Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA), për ndërhyrje në frekuencat e punës në bordet e avioneve. Për të dy fenomenet e përmendura, nga verifikimi, është konstatuar se burim i këtyre interferencave kryesisht kanë qënë pajisjet e operatorëve radio-televizive. Për këto raste, janë bërë bllokime të funksionimit të këtyre pajisjeve si dhe njoftime me shkresa përkatëse KKRT-së për marrje masash si autoritet që ka nën juridiksion këto subjekte.

Puna e njësisë monitoruese është mbështetur me përmirësimin e kushteve teknologjike të punës duke prokuruar aparatura dhe pajisje të teknologjisë së fundit për monitorim të të gjithë spektrit të frekuencave dhe treguesve të cilësisë si dhe është bërë trajnimi i stafit të kësaj njësie.

Për vitin 2012, u realizua përditësimi i sistemit ARGUS të njësisë së lëvizshme të monitorimit dhe trajnimi i specialisteve për përdorimin e tij. Gjithashtu, u realizua edhe trajnimi i specialistëve të monitorimit për përdorimin e programeve Tems (investigation,

discover) që përdoren në matjet e parametrave të cilësisë të rrjeteve të operatorëve të telefonisë së lëvizshme.

Me asistencë të një eksperti të ITU-së, në vitin 2012, u bashkëpunua për hartimin e studimit për krijimin e sistemit kombëtar të monitorimit. Projekti përfshin dhe monitorimin e frekuencave për transmetimet radiotelevizive. Pritet raporti perfundimtar i ITU-së në bazë të të cilit do punohet për sigurimin e fondeve për prokurimin e tij.

#### **4.2 Veprimtaria inspektuese**

Në zbatim të planit vjetor të miratuar nga Këshilli Drejtues dhe nevoja urgjente të institucionit, në vitin 2012 janë kryer 49 inspektime në sipërmarrës të komunikimeve elektronike, nga të cilat 47 kanë qënë me tematikë sipas planit të miratuar dhe 2 me tematikë të përcaktuar sipas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve të Brëndshme.

Objekti i inspektimeve ka qënë verifikimi i zbatimit të kushteve të autorizimit të përgjithshëm, individual si dhe rregulloreve të nxjerra nga AKEP.

Nga këto inspektime u konstatua se;

- 37 subjekte ofrojnë shërbime në përputhje me kushtet e autorizimeve dhe rregulloreve të AKEP;
- 12 subjekte nuk kishin zbatuar rregulloret e AKEP dhe për këtë arsye u vendosen masa administrative me gjobë. Nga AKEP është arkëtuar vlera e gjobës për 11 prej këtyre subjekteve në masën 211 559.69 Lek dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit 205 560.31 Lek.
- 6 sipërmarrës nuk ushtronin aktivitet, pasi kishin kaluar në status pasiv.

Veprimtaria inspektuese është realizuar në përputhje të plotë me rregulloren “Për inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”, miratuar me VKD Nr.1516, datë 31.01.2011, dhe ka patur si qëllim jo vetëm kontrollin e subjekteve në zbatimin e ligjshmërisë dhe kuadrit rregullator të fushës, por dhe ndihmesën dhe këshillimin për ushtrimin sa më korrekt të veprimtarisë.

#### **5. Veprimtaria juridike për rregullim**

Veprimtaria juridike e AKEP gjatë vitit 2012, kryesisht është investuar në:

- Hartimin e akteve ligjore dhe rregullatore, hartimin e ndryshimeve dhe të shtesave në aktet e nxjerra/propozuara nga AKEP.
- Ndjekjen e procedimeve administrative të inicuar nga palet ose AKEP;
- Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.
- Përfaqësimin e AKEP si palë ndërgjyqëse në proceset gjyqësore dhe ndjekjen e procedurave në të gjitha shkallët e gjykimit;
- Shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në adresë të AKEP nga të autorizuarit dhe palë të treta, trajtimi i tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi;

**5.1 Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore dhe rregullatore, hartimi i ndryshimeve dhe shtesave në aktet e nxjerra/propozuara nga AKEP.**

##### **5.1.1 Ndryshimet në ligjin 9918**

---

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

Faks : + 355 4 2259 106

[www.akep.al](http://www.akep.al)

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

AKEP, gjatë vitit 2012, ka dhënë kontributin në hartimin e ligjit 102/2012, datë 24.10.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë””.

Me miratimin e ligjit 102/2012 u finalizua puna dhe kontributi tre vjecar për transpozimin e ndryshimeve të ndodhura në vitin 2009 në paketën rregullatore të BE-së, nepërmjet ndryshimeve dhe shtesave në ligjin 9918.

### ***5.1.2 Propozime për akte nënligjore;***

Pasi realizoi procedurën ligjore të këshillimit publik me palët e interesit, AKEP i dërgoi MITIK projektdokumentin “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 599, datë 23.07.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike””. Propozimi i AKEP u materializua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 911, datë 19.12.2012.

### ***5.1.3 Rregullore***

AKEP ka punuar për plotësimin normativ të kuadrit rregullator në sektorin e komunikimeve elektronike në zbatim të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis BE-së dhe Republikës së Shqipërisë. Me hartimin dhe miratimin e rregulloreve të mëposhtme gjatë vitit 2012, numri i rregulloreve gjithsej të miratuara dhe zbatuara arriti në 28:

- Rregullore “Për Autorizimin e Përgjithshëm”-miratuar me VKD Nr. 1774, datë 02. 02. 2012
- Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, ndryshuar me VKD Nr. 1530, datë 18.3.2011”-miratuar me VKD Nr.1776, datë 20.02.2012
- Rregullore “Per pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre”- miratuar me VKD Nr.1977, datë 14.06.2012.
- Rregullore “Mbi përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe publikimin e komenteve të këshillimit publik”-miratuar me VVKD Nr. 2140, datë 16.08.2012.
- Rregullore “Mbi publikimin e tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut”-miratuar me VKD Nr. 2161, datë 21.09.2012.
- Rregullore “Per të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”- miratuar me VKD Nr.2231, date 28.12.2012.

## **5.2. Procedimet administrative për zgjidhje të mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve**

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

[www.akep.al](http://www.akep.al)

Faks : + 355 4 2259 106

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

Në bazë të nenit 8, gërma (n) të ligjit 9918, të ndryshuar, AKEP ka ushtruar kompetencat e tij në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve nëpërmjet kryerjes së 15 procedimeve administrative kundrejt 18 të tillave në vitin 2011.

1. *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega Shqipëri dhe Albtelecom sh.a.:*
  - Vendimi nr. 1685, datë 19.09.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega Shqipëri dhe Albtelecom sh.a.”
  - Vendimi nr. 1757, datë 20.1.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1685, datë 19.09.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega Shqipëri dhe Albtelecom sh.a.””
2. *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a.:*
  - Vendimi nr. 1686, datë 19.09.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a.”
  - Vendimi nr. 1758, datë 20.1.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1686, datë 19.09.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Unifi Holdings Inc. Dega Shqipëri dhe Eagle Mobile sh.a.””
3. *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.:*
  - Vendimi nr. 1731, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.”
  - Vendimi nr. 1870, datë 10.4.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1731, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Nisatel sh.p.k.”” dhe Urdhëri nr. 1, datë 10.4.2012 për lidhjen e MI.
4. *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a.:*
  - Vendimi nr. 1730, datë 20.12.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”
  - Vendimi nr. 1862, datë 10.4.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1730, datë 20.12.2011,, “Për fillimin e procedimit

administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a. dhe Albtelecom sh.a.””

**5.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.:*

- Vendimi nr. 1763, datë 2.2.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”.
- Vendimi nr. 1935, datë 7.5.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1763, datë 2.2.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”.

**6.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.:*

- Vendimi nr. 1882, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.”.
- Vendimi nr. 1957, datë 24.5.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1882, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Vodafone Albania sh.a.”.

**7.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.:*

- Vendimi nr. 1878, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.”.
- Vendimi nr. 1955, datë 24.5.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1878, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Eagle Mobile sh.a.”.

**8.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.:*

- Vendimi nr. 1910, datë 30.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”.
- Vendimi nr. 1959, datë 24.5.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1910, datë 30.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”.

**9.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.:*

- Vendimi nr. 1863, datë 10.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”.
  - Vendimi nr. 1976, datë 14.6.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1863, datë 10.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Eagle Mobile sh.a.”.
- 10.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.*
- Vendimi nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit (për KPP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”.
  - Vendimi nr. 1978, datë 14.6.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1881, datë 19.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit (për KPP) midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k. dhe Albanian Mobile Communications sh.a.” dhe Urdhëri nr. 2, datë 14.6.2012 për lidhjen e MI.
- 11.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.:*
- Vendimi nr. 1871, datë 11.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit (për KPP) midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”
  - Vendimi nr. 2065, datë 14.6.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1871, datë 11.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit(për KPP) midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”
- 12.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.:*
- Vendimi nr. 1911, datë 30.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”
  - Vendimi nr. 2068, datë 14.6.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1911, datë 30.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo AL sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”
- 13.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Media + Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.:*
- Vendimi nr. 1912, datë 30.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit (për KPP) midis sipërmarrësve Media + Tel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”

- Vendimi nr. 2067, datë 14.6.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1912, datë 30.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit (për KPP) midis sipërmarrësve Media + Tel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.”
- 14.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a.:*
- Vendimi nr. 1974, datë 1.6.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a”
  - Vendimi nr. 2069, datë 21.6.2012, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1974, datë 1.6.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Altelecom sh.a”.
- 15.** *Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.:*
- Vendimi nr. 2141, datë 16.8.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të Repartit Ushtarak 1040 dhe Repartit Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.”
  - Vendimi nr. 2197, datë 23.11.2012, “Për Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 2141, datë 16.8.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të Repartit Ushtarak 1040 dhe Repartit Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.”

### **5.3 Ankime administrative**

Gjatë vitit 2012, AKEP ka shqyrtuar 13 ankime administrative që kanë rezultuar në vendime të Këshillit Drejtues:

1. Vendim nr. 2163, datë 21.09.2012 për “Shqyrtimin e ankimimit administrative të Altelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 2122, datë 04.07.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktim e Sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese””.
2. Vendim nr. 2162, datë 21.09.2012, për “Shqyrtimin e ankimimit administrative të Altelecom sh a në lidhje me Aktin Administrativ Vendimi nr. 2119 datë 04.07.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e Sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”” .



3. Vendim Nr. 2148 date 29.08.2012 për “Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Nisatel sh.p.k, ndaj VKD Nr. 2118, datë 04.7.2012, Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtarë” dhe Vendimin nr. 2122, datë 04.7.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””
4. Vendim Nr. 2147 date 29.08.2012 për “Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Abcom sh.p.k., ndaj VKD Nr. 2118, datë 04.7.2012, Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtarë” dhe Vendimin nr. 2122, datë 04.7.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””
5. Vendim Nr.2146 date 29.08.2012 për “Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Abissnet sh.a., ndaj VKD Nr. 2118, datë 04.7.2012, Analizë e tregut celular. tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtarë” dhe Vendimin nr. 2122, datë 04.7.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””
6. Vendim Nr.2145 date 29.08.2012 për “Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Atel sh.p.k., ndaj VKD Nr. 2118, datë 4.7.2012, Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit – Dokumenti Përfundimtarë” dhe Vendimin nr. 2122, datë 4.7.2012 “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese””
7. Vendim Nr. 2135 date 19.07.2012, për “Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 1975, datë 31.5.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelecom sh.a.””
8. Vendim Nr. 1964 date 31.05.2012 Për “Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1886, datë 19. 4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Vodafone Albanian sh.a””
9. Vendim Nr. 1963 date 31.05.2012 Për “Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1884, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albtelecom sh.a.””
10. Vendim Nr.1962 date 31.05.2012 Për “Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1883, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit në zbatim, të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a.”.
11. Vendim Nr. 1961 date 31.05.2012 Për “Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1885, datë 19.4.2012, të Këshillit Drejtues të

AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit në zbatim të Eagle Mobile sh.a.””

12. Vendim Nr. 1880 date 19.04.2012 Për “Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.2.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit””.
13. Vendim Nr. 1879 date 19.04.2012 Për “Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.02.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit””.

#### **5.4 Pjesëmarrja në proçese gjyqësore**

Gjatë vitit 2012, AKEP ka marrë pjesë në 13 proçese gjyqësore, ndër të cilat në 12 çështje është thirrur si palë e paditur dhe në 1 çështje si palë e tretë.

Proçeset gjyqësore ku AKEP është në cilësinë e palës së paditur kanë statusin e meposhtem;

- 3 çështje janë në vazhdim;
- për 5 çështje është pushuar gjykimi për arsye mosparaqitje të palës paditëse, heqje dore nga pala paditëse, etj;
- për 3 çështje është rrëzuar kërkesë padia; dhe
- dhe për 1 çështje kemi pranim të pjesshëm të padisë.

Nga totali i proçeseve gjyqësore ku AKEP është palë e paditur 7 çështje janë për pavlefshmeri ose ndryshim të pjesëshëm të vendimeve të AKEP, si dhe 1 çështje është për kundërshtim të detyrimit tatimor.

### **6. Struktura dhe burimet njerëzore**


Në zbatim të Ligjit Nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuar me ligj” i ndryshuar, dhe Vendimit të Kuvendit nr. 97, datë 30.04.2007, të ndryshuar, është miratuar struktura organizative dhe organika e ERT-së, (AKEP), strukturë që është në fuqi, të punonjësve në 60 vetë. Me këtë strukturë AKEP ka funksionuar dhe në vitin 2012.

Duke qënë se:


- struktura dhe organika e AKEP (ish-ERT) është miratuar para ligjit 9918, ekzistojnë vështirësi në punën e përditëshme gjatë implementimit të kësaj strukture;
- funksionet rregullatore postare nga Ministri i linjës kanë kaluar në AKEP në bazë të ndryshimeve të Ligjit nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”;
- janë shtuar detyrimet ligjore me ndryshimet e ligjit 9918; si dhe

me qëllim rritjen e fleksibilitetit, efektivitetit dhe transparences së ofrimit të shërbimeve nga AKEP, është domosdoshmëri miratimi i një strukture dhe organike të re.

Përbërja strukturore e punonjësve të AKEP jepet në grafikët e mëposhtëm:



Te punesuar gjithsej (60)



Duke qenë se AKEP është një institucion që mbikqyr sektorë shumë të specializuar sic janë ato të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare, është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit. Gjatë vitit 2012, është shfrytëzuar cdo mundësi trajnimi financiar nga fondet e AKEP, të organizatave ku vendi ynë është anetar dhe kontribues si dhe të institucioneve homologe.

Trajnimet e kryera janë bazuar në domosdoshmërinë e rritjes të kapaciteteve administrative dhe profesionale si dhe përmbushjen e objektivave të AKEP.

▪ **Trajnimet e kryera për rritjen e kapaciteteve administrative dhe profesionale:**

- Trajnim për “Rregulimin e Telekomunikacioneve” në Stamboll, organizuar nga Autoriteti i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimeve – ICTA, në Turqi
- Për Masterizimin e rregullimit European të telekomunikacioneve- organizuar nga Cullen International-firme konsulente e fushës e kontraktuar nga KE për monitorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në vendet në zhvillim.

- Trajnim mbi Transmetimet Televizive Tokësore Dixhitale dhe Dividentin Dixhital për Europën-organizuar nga ITU.
- Seminari mbi Menaxhimin Europian të Spektrit dhe Numeracionit-organizuar nga CEPT (Konferenca Europiane e Post-Telekomunikacioneve)
- Trajnim në distancë “Interneti i se Ardhmes” organizuar me mbështetjen e Rrjetit të Qendrës së Ekselencës së ITU për Europën.
- **Trajnimet e kryera në nevojë të përmbushjes së objektivave të AKEP:**
- Marrje eksperience në rregullatorin e Rumanise dhe Maqedonise lidhur me procedurat e analizës së tregjeve, analizat e tregjeve me pakicë të telefonisë fikse, tregu fiks i interkoneksionit, ndarja e llogarive, etj
- Asistenca nga ITU: 1) për përmirësime në planin e numeracionit dhe 2) ngritjen e një qendre kombëtare monitorimi.

### III. STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL DHE MBROJTJA E PËRDORUESVE

#### 1. Shërbimi Universal

Sic është raportuar edhe vitin e kaluar, Banka Botërore ofroi asistencë në procesin e implementimit të Shërbimit Universal (SHU) në Shqipëri. Objektivi kryesor i projektit është ndihma për AKEP në identifikimin e objektivave dhe zhvillimin e një kuadri të plotë për SHU.

Puna filloi në Mars 2012, me zhvillimin e takimeve të para të konsulentit dhe përfaqësuesit të BB për projektin me AKEP, MITIK si dhe me lojtarët kryesorë të tregut. Pas një bashkëpunimi me të gjithë aktorët e tregut, konsulenti përgatiti dokumentin “Detyrimi i shërbimit universal (DSHU)- Dokument konsultimi publik”, i cili u publikua me 1.11.2012 në faqen e Internetit të AKEP për konsultim publik një mujor me palet e interesuara. Në përfundim të këtij procesi konsultimi, operatorët kryesorë në treg dhanë komentet dhe shumica e palëve të interesuara ishin dakort me mënyrën e trajtimit dhe vlerësimit të SHU. AKEP, në bashkëpunim me MITIK, BB dhe konsulentin, më datë 20.12.2012, zhvilloi një seminar “Për Shërbimin Universal në Shqipëri”.

Konsulenti në fund të muajit Dhjetor dërgoi në AKEP, raportin final me rekomandimet përkatëse për implementimin e SHU në Shqipëri. Ky dokument u publikua edhe në faqen e Internetit të AKEP. Disa nga përfundimet kryesore të analizës së situatës aktuale dhe rekomandimet për hapat e mëtejshme për SHU në Shqipëri të konsulentit janë dhënë më poshtë.

#### **Parimet kryesore për implementimin e shërbimit universal:**

- **Së pari, Zgjidhjet e Tregut.** Kur është e mundur, mekanizmat e tregut duhet të jenë mënyra e preferuar e plotësimit të objektivave të shërbimit universal. Në këtë kontekst, AKEP duhet të vazhdojë për të siguruar që tregjet janë duke punuar mirë dhe të eliminojë çdo pengesë rregullatore për konkurrencën e tregut. Ndërhyrja rregullatore në formën e vendosjes së një regjimi të detyrimit të SHU të bazuar në përcaktim në përputhje me DSHU, duhet të konsiderohet me kujdes bazuar në kushtet

kombëtare dhe statusin e sektorit. Çdo ndërhyrje e tillë duhet të bazohet në një vlerësim që ka përfitime neto në krahasim me alternativën e zgjidhjeve të tregut.

- **Çdo ndërhyrje duhet të jetë në proporcion me kushtet kombëtare.** Parimi i proporcionalitetit është një faktor kyç në vlerësimin kosto/ përfitim për krijimin e një regjimi të SHU në përputhje me Direktiven e Shërbimit Universal të KE. Vendet anëtare të BE që kanë pasur sukses në përdorimin e mekanizmave të financimit të shërbimit universal (FSHU) janë vende shumë më të mëdha dhe me të ardhura më të larta se Shqipëria. Kjo mund të jetë për shkak se vendet e mëdha kanë tendencë të kenë popullsi më të madhe absolute në zonat rurale dhe të izoluara dhe kështu një masë më të madhe kritike që përligj shpenzimet administrative, financiare dhe të burimeve njerëzore për krijimin e një FSHU. Në të njëjtën mënyrë, vende të tilla gjithashtu kanë burime financiare dhe njerëzore për të krijuar dhe administruar një regjim të tillë. Ndërkohë, vendet e vogla dhe me të ardhura të ulëta në përgjithësi nuk kanë krijuar FSHU, ose në qoftë se ato e kanë bërë këtë, shkalla e suksesit në këto vende ka qenë më e ulët pikërisht për arsyet e kundërta të përmendura më lart.
- **DSHU duhet të implementohet duke reflektuar statusin kombëtar të sektorit.** Analiza e kryer tregon ndër Vendet Anëtare të BE dhe vendet e rajonit ka një variacion të konsiderueshëm në mënyrat e implementimit të elementeve të SHU dhe se variacioni i tillë duket së është i bazuar në kushtet kombëtare dhe konsideratat administrative. Duke marrë parasysh kushtet kombëtare dhe konsideratat administrative vendet e BE-12 (të futura më vonë në BE) dhe rajonit SEE mund të jenë relativisht më të krahasueshme me Shqipërinë. Bazuar në mbulimin dhe penetrimin celular (kudo) disa prej këtyre vendeve (p.sh. Republika Çeke, Rumania dhe Mali i Zi) kanë vendosur që disa shërbime fikse të ofruara nga rrjetet celulare plotësojnë gjithashtu kriteret për akses dhe shërbim nga vendndodhje fikse. Në këto vende ky element i detyrimit të SHU nuk është përcaktuar (për shkak se ai është i disponueshëm në kushtet e tregut) ose një operator celular është caktuar si ofrues i këtij elementi të detyrimit të SHU.
- **Siguri ligjore dhe korrektësi procedurale.** Siç është vërejtur në shumë vende anëtare të BE-së zbatimi i DSHU ka qenë objekt i vonesave administrative dhe apelimeve gjyqësore në lidhje me përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal, llogaritjen e kostove neto të DSHU dhe pagesën në mekanizmin e kontributit të sektorit. Në këtë kontekst, konulentit rekomandon që në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe rajonale, të përgatiten rregullore që do të plotësojnë parashikimet e ligjit 9918, të ndryshuar, për shërbimin universal.
- **Analiza dhe planifikimi i ardhshëm.** Implementimi i plote i shërbimit universal do të jetë një proces shumë-vjeçar dhe në këtë kontekst, Plani Kuader i shërbimit universal duhet që jo vetëm të shikojë situatën e tanishme, por gjithashtu, bazuar në tendencat dhe vlerësimet aktuale, të shikojë së çfarë situatë ka të ngjarë të jetë në të ardhmen e afërt dhe atë afatmesme. Për këtë arsye, Plani Kuadër duhet të hartohet për të krijuar mundësinë e rishikimit dhe përditësimit të tij, siç kërkohet, por duhet

gjithashtu të ketë një kohezgjatje tre-vjecare, pas së cilës ai duhet të rishikohet, d.m.th rreth Dhjetor 2015.

### **Vlerësimi i situatës së elementeve të shërbimit universal**

#### **- Aksesit dhe shërbimet nga vendndodhje fikse**

Zhvillimi i sektorit në Shqipëri ka qënë disi i ndryshëm nga situata në vendet e BE në vitin 2002, kur KE miratoi direktivën e Shërbimit Universal. Në këto vende penetrimi i telefonisë fikse ka qënë shumë i lartë i ndryshim nga Shqipëria në atë kohë dhe aktualisht. Duke pasur parasysh dëndësinë celular/fikse dhe dinamikën e mbulimit, disa vende kanë vendosur që shërbimet fikse të ofruara nga rrjetet mobile plotësojnë kriteret për këtë element të shërbimit universal. Një shërbim i ngjashëm është aktualisht i disponueshëm në Shqipëri (AMC Fiks) dhe AKEP ka arritur në përfundimin se këto shërbime janë pjesë e tregjeve përkatëse me pakicë të aksesit/thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse. Një shërbim i tillë përdor një aparat telefonik fiks të pajisur me kartë GSM dhe me numër gjeografik fiks dhe mund të përfitohet kudo ku mbulim GSM (99.8% e popullsisë). Rrjetit GSM i AMC në kombinim me rrjetin e Albtelecom dhe operatoreve të tjerë fiks, mbulon rreth 99,8% të popullsisë. Në këndvështrimin e konsulentit, ky mbulim popullsie tregon se ky element i shërbimit universal aktualisht është shumë afër disponueshmerise universale në Shqipëri. Bazuar në këtë vlerësim, konsulenti konsideron se tregu aktualisht plotëson nevojat e përdoruesve fundore në lidhje me disponueshmërinë e këtij elementi të shërbimit universal. Më tej, analiza e kryer në dokumentin e konsultuar tregon se shërbimi telefonik fiks në përgjithësi dhe shërbimi i Albtelecom dhe AMC Fix në mënyrë specifike janë të disponueshme me çmime të përballueshme, për kushtet kombëtare në Shqipëri - prandaj, nuk ka nevojë që në këtë element të Shërbimit Universal të përfshihet një tarifë sociale.

Në këtë mënyrë, konsulenti konsideron se Shqipëria plotëson në masë të konsiderueshme detyrimin e SHU që ky element "të jete i disponueshëm për të gjithë përdoruesit kudo në territorin e Shqipërisë, me një çmim të përballueshëm". Konsulenti rekomandon që Shqipëria nuk ka nevojë të përcaktojë këtë element të SHU duke përcaktuar ofrues të Shërbimit Universal. AKEP mund të koordinojë/inkurajojë një ose disa operatorë të ofrojnë akses në vendndodhje specifike që nuk kanë shërbim jashtë skemës së SHU. Konsulenti i rekomandon AKEP që të rishikojë statusin e këtij elementi në fund të vitit 2015.

#### **- Aksesit Broadband**

Konsulenti është kundër përfshirjes së aksesit broadband si element të SHU në këtë kohë. Analiza tregon se aksesit broadband fikse dhe mobile po rriten me shpejtësi në Shqipëri - në fakt, tregu broadband nuk është ende i maturuar dhe një ndërhyrje me detyrime të SHU nuk do të ishte e përshtatshme në dinamikën e tilla të tregut, sepse kjo do të ishte shumë herët për të konkluduar se tregu nuk ka qënë në gjendje për të përmbushur nevojat e përdoruesve. Në të vërtetë, mbulimi me rrjet broadband (si fikse dhe mobile) janë më të gjera se niveli i penetrimit, duke treguar se

disponueshmëria është më e madhe se të perqindja e personave që kanë aktualisht akses dhe se ndërhyrja me detyrim të SHU nuk do të ishte e përshtatshme edhe nga ky këndvështrim. Më tej, tregu broadband në Shqipëri nuk përmbush "Rregullin 50/80" të BE për përfshirjen e broadband në detyrimet e SHU. Siç është përcaktuar në dokumnetin e kosultuar, kostoja e përfshirjes së broadband në detyrimet e SHU në Shqipëri do të ishte shume jashtë niveleve të rekomanduara nga KE dhe do të përbënte një barrë disproporcionale në sektorin e telekomunikacioneve të Shqipërisë. Në mënyrë të përmbledhur, promovimi i broadband nëpërmjet detyrimeve të SHU nuk është mekanizmi i përshtatshëm në këtë kohë. Konsulenti rekomandon që AKEP të shqyrtojë këtë çështje me 31 dhjetor 2015. Ndërkohë, në qoftë se Qeveria Shqiptare e konsideron të përshtatshme, Ajo mund të dëshirojë të marre në konsideratë mekanizma të tjerë për promovimin broadband, duke përfshirë ato të përcaktuara në Projekt Planin Kombëtar Broadband.

#### - **Numeratori telefonik dhe rubrika e informimit për numrat**

Aktualisht, Shqipëria nuk disponon numerator telefonik apo shërbim të kërkimit të informacionit në numëror. Albtelecom ofron informacion për numrat e pajtimtarëve të tij nëpërmjet numrit të shkurtër 124, nderkohe as operatorët alternativë dhe as operatorët celularë nuk ofrojnë numerator apo shërbim për kërkimin e informacionit në numëror për pajtimtarët e tyre. Shqipëria aktualisht nuk e ka përmbushur detyrimin e SHU për këtë element.

Konsulenti nuk rekomandon që Shqipëria të caktojë këtë element të SHU në këtë kohë, por gjithsesi konsideron si kritike që secili prej operatorëve të fillojë procesin e ndërtimit të bazës së të dhënave përkatëse të tyre me qëllimin e arritjes së një zgjidhjeje të ardhshme nga tregu për këtë element të SHU. Ndërkohë AKEP mund të marrë në konsideratë sigurimin e kuadrit rregullator për shkëmbimin e këtij lloji informacioni të lidhur me numërorin midis operatorëve dhe palës që ofron këto shërbime. Zbatimi i dispozitave të tilla rregullatore mund të krijojë kushtet e tregut për një palë të tretë ose për një nga operatorët për të kërkuar informacion nga të gjithë operatorët për të formuluar një numëror të plotë apo shërbime të kërkimit të informacionit në numëror. Konsulenti rekomandon që AKEP të rishikojë statusin e këtij elementi në Dhjetor 2015.

#### - **Disponueshmëria telefonave Publike me Pagesë**

Densiteti i telefonave publike me pagesë ka qënë në rënie në të gjithë BE dhe vendet e rajonit. Densiteti i telefonave publike me pagesë në Shqipëri është edhe më poshtë se nivelet mesatare në BE dhe rajon. Rënia në densitetin e telefonave publike me pagesë në të gjithë kontinentin pasqyron një trend botëror të gjerë që reflekton përdorimin dhe nevojën e reduktuar për telefonat publike me pagesë për shkak të preferencave të konsumatorit për alternativa konkurruese, përfshirë mbulimin dhe aksesin global celular.

Për të pasqyruar këtë dinamike të tregut, disa vende të BE nuk e kanë përcaktuar disponueshmërinë e telefonave publike me pagesë si një element të detyrimeve të

SHU, për shkak të arritjes në përfundim se përfshirja e këtij elementi nuk është efiçente ose se kostot janë më të mëdha se përfitimet për shkak të përdorimit në rënie të tyre.

Konsulenti nuk rekomandon që ky element i SHU të përcaktohet nga AKEP, pasi një përcaktim i tillë nuk do të ishte proporcional për shkak të përdorimit dhe rëndësisë në rënie të këtij elementi. Nëse është e përshtatshme, AKEP mund të koordinojë/inkurajojë një ose më shumë operatorë që të ofrojnë telefona publike me pagese në vende të veçanta, por jashtë çdo skeme të detyrimeve të SHU. Konsulenti rekomandon që AKEP të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në Dhjetor 2015.

#### - **Masat për përdoruesit me aftësi të kufizuar**

Aktualisht, Qeveria Shqiptare parashikon një pagesë mujore prej 1000 lekë për përdoruesit me aftësi të kufizuara për të ndihmuar në financimin e pagesës së shërbimeve të telekomunikacionit. Bazuar në paketa të veçanta që janë vënë në dispozicion nga Albtelecom, një subvencion i tillë pagese nga Qeveria Shqiptare lejon që përdorues të tillë me aftësi të kufizuara të blejnë një paketë të kombinuar të telefonisë dhe broadband që përfshin përdorim në masë të konsiderueshme të këtyre shërbimeve. Gjithashtu, disa operatorë fikse dhe mobile në baza komerciale dhe si pjesë e aktiviteteve të bazuara në komunitet, ofrojnë masa/pajisje dhe skonto specifike për përdoruesit me aftësi të kufizuara. Të dyja këto iniciativa të QSH dhe sektorit privat janë të disponueshme në të gjithë territorin kombëtar.

Për sa më sipër konsulenti rekomandon që nuk është e nevojshme për Shqipërinë që të përcaktojë këtë element të detyrimeve të SHU deri në një periudhë afat mesme. AKEP mund të koordinojë/inkurajojë një ose më shumë operatorë për të siguruar masa specifike jashtë çdo skeme të detyrimeve të SHU. Konsulenti rekomandon që AKEP të rishikojë statusin e këtij elementi të detyrimeve të SHU në Dhjetor 2015.

#### **Plani Kuadër për Shërbimin Universal**

Konsulenti në përfundim të analizave të kryera ka dhënë disa rekomandime për hapat e mëtejshme për SHU në Shqipëri, duke i ndarë në tre faza, periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

#### **Periudhë Afat shkurtër (0-12 muaj)**

1. Nuk është e nevojshme që të përcaktohet ndonjë element i detyrimeve të SHU ose ofrues i SHU. Prandaj, nuk është e nevojshme të miratohen masa të tjera të lidhura me SHU (p.sh. kërkesa për kompensim; mekanizmi i financimit sektorial nëpërmjet mbledhjes së kontributeve të operatorëve (fondi i SHU), etj).

2. Për të përmbushur pritshmëritë e tregut në lidhje me përfundimet e konsultimit publik të kryer në Nentor 2012, mund të shërbejë dokumenti i publikuar nga AKEP në faqen e Internetit për Seminarin e zhvilluar më 20 Dhjetor, 2012. Për të formalizuar konkluzionet



në lidhje me përcaktimet e DSHU, AKEP nese e konsideron të përshtatshme mund te nxjerrë vendime përkatëse.

3. Të hartohen dhe përgatiten për konsultim publik masat rregullore për të promovuar zgjidhjet nga ana e tregut për numërorin telefonik dhe shërbimet e kërkimit të informacionit për numrat, duke përfshirë krijimin e bazës së të dhënave të secilit operator për pajimtarët e vet dhe për akses dhe shkëmbim të këtij informacioni nga palë të treta.

4. Të hartohen dhe përgatiten për konsultim publik Rregulloret dhe aktet e tjera nënligjore të SHU të referura në ligjin 9918, i ndryshuar, për të plotësuar dispozitat përkatëse të Ligjit, si mënyrë për të siguruar më shumë detaje dhe specifikime, duke përfshirë në lidhje me kriteret, procedurat dhe metodologjinë, çështjet administrative.

### **Në periudhë Afatmesme (13-24 muaj)**

Nëse është e nevojshme, AKEP të ndërmarrë një studim dhe analizë më të detajuar të masave për akses ekuivalent për përdoruesit me aftësi të kufizuara.

### **Në periudhë Afat-gjatë (25-36 muaj)**

Rishikimi i statusit të detyrimeve dhe përcaktimeve të SHU pas 3 viteve.

Pas këtij procesi dhe bashkëpunimi të sukseshëm me MITIK, Bankën Botërore, Konsulentin dhe lojtarët e tregut, AKEP është duke shqyrtuar rekomandimet finale të konsulentit.

## **2. Masa për mbrojtjen e konsumatorit dhe përdoruesve fundorë**

Duke konsideruar se një nga objektivat rregullore të AKEP është mbrojtja e interesave të përdoruesve dhe sigurimi i përfitimeve maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, puna e AKEP gjatë vitit 2012 është fokusuar në:

- Miratimin e kontratave të telefonisë dhe aksesit në internet;
- Vendosjen e detyrimit operatorëve për instalimin e Matësit të Shpejtësisë (Speedtest) dhe përfshirjen në kontrata të Treguesve të Cilësisë për aksesin në Internet;
- Miratimin e rregullores “Mbi Publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.
- Përmirësimin dhe përditësimin e informacionit në faqen *Web* në ndihmë të përdoruesit

Bazuar në përpjekjet dhe rezultat e arritura në këtë drejtim Zyra e Mbrojtjes së Konsumatorit ka vlerësuar AKEP, për të dytin vit të rradhazi, me “Çmimin European të Konsumatorëve Shqiptarë”

### **2.1. Miratimin e kontratave të telefonisë dhe aksesit në internet**

Gjatë vitit 2012 AKEP miratoi termat dhe kushtet e përgjithshme për 61 kontrata për shërbim telefonik fiks dhe 98 për shërbim aksesit në Internet për 107 sipërmarrës të komunikimeve elektronike. Miratimi i këtyre kontratave rrit mbrojtjen e konsumatorit për shërbimet e komunikimeve elektronike.

## **2.2. Vendosjen e detyrimit operatorëve për instalimin e Matësit të Shpejtësisë (Speedtest) dhe përfshirjen në kontrata të Treguesve të Cilësisë për aksesin në Internet**

Me VKD nr.2165, datë 12.10.2012, miratoi disa shtesa në kontratat e miratuara për shërbimin e aksesit në Internet, sipas të cilave secili operator që ofron këtë shërbim për përdoruesit fundore, midis të tjerave:

- ka detyrim që në faqen kryesore të website zyrtar të tij të ofrojë një instrument matje të shpejtësisë së aksesit në Internet për pajtimtarët e vet (speedtest). Matësi i shpejtësisë ofron mundësinë për të matur të paktën:
  - download speed (shpejtësinë e shkarkimit) në Mbps ose Kbps.
  - upload speed (shpejtësinë e ngarkimit) në Mbps ose Kbps.
  - latency (vonesën e lidhjes) në milisekonda.
- ka detyrimin e përfshirjes në Aneks të kontratave të disa parametrave cilësorë teknike, të tillë si:
  1. *shpejtësia nominale/maksimale e transmetimit të të dhënave:*
    - a. download \_\_\_\_\_(kbps/Mbps);
    - b. upload \_\_\_\_\_(kbps/Mbps).
  2. *shpejtësia minimale e garantuar e transmetimit të të dhënave:*
    - a. *Po, garantojmë minimalisht \_\_\_\_\_ (kbps/Mbps)*
    - b. *Jo, nuk garantojmë shpejtësi minimale pasi ofrimi i shërbimit bazohet në përpjekje më të mira (best effort).*
  2. *vonesa në transmetim, nëse ofruesi siguron një vlerë te caktuar;*
  3. *devijimi në vonesën në transmetim, nëse ofruesi siguron një vlerë te caktuar*
  4. *norma e humbjes së paketave, nëse ofruesi siguron një vlerë te caktuar*

## **2.3. Miratimin e rregullores “Mbi Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.**

AKEP, për ti ardhur në ndihmë përdoruesit si dhe me kërkesën/sugjerimin e deputetëve të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, inicioi hartimin e një rregulloreje për transparencë të tarifave dhe kushtet e ofrimit të shërbimit nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike. Pas procesit të konsultimit publik, me VKD nr. 2161, datë 21.09.2012, AKEP miratoi Rregulloren Nr. 27 datë 21.09.2012 “*Mbi Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*”.

Rregullorja përcakton llojin e informacionit që sipërmarrësit e komunikimeve elektronike duhet të publikojnë në faqet e tyre të internetit në lidhje me kushtet e ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe tarifatat e këtyre shërbimeve. Ndër detyrimet kryesore mund të përmendim:

- Secili sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun duhet të zotërojë një faqe Interneti me domain “.al” ku të publikojë të gjithë informacionin e nevojshëm për shërbimet e ofruara dhe tarifatat e tyre;

- Informacioni i dhënë në faqen e internetit të sipërmarrësit duhet të jetë i qartë, i dukshëm, dhe lehtësisht i aksesueshëm, domethënë në të njëjtën faqe (seksion) ku publikohet shërbimi (paketa tarifore) që ofrohet ose nëpërmjet nje seti link-esh për këtë qëllim, me madhësi dhe prezantim grafik që të mundësojë identifikim të lehtë të tyre.
- Informacioni duhet të jepet pa pagesë dhe në mënyrë të shkruar në të gjitha pikat e shitjes. Personeli në pikat e shitjes duhet të japë informacion të detajuar dhe sqarime për përdoruesit/të interesuarit dhe të disponojë në formë të printuar (në formë fletë palosje) çdo paketë tarifore të ofruar. Për ofertat/promocionet në fuqi, sipërmarrësi duhet të garantojë informacionin në formë fletpalosjesh ose të mundësojë dhënien e informacionit për ato në formë të printuar kur i kërkohet nga përdoruesit/të interesuarit.
- Operatorët celularë duhet të publikojnë tarifat e shërbimeve celulare në roaming ndërkombëtar për cdo shtet ku ofrohet shërbimi dhe i detajuar për cdo lloj thirrje/SMS/data hyrëse dhe dalje;
- Tarifa e publikuara duhet të përfshijnë TVSH;

Një theks i vecantë në rregullore dhe në diskutimet me operatorët i'u kushtua informacionit të publikuar nga operatorët celularë për tarifat e shërbimeve të roamingut ndërkombëtar. Situata e tarifimit të këtyre shërbimeve është më komplekse se e shërbimeve të tjera pasi operatorët celularë vendas janë të varur nga tarifat e vendosura nga operatorët e huaj. Megjithatë tashme operatorët celularë kanë bërë përmirësime të ndjeshme në publikimin e këtyre tarifave duke rritur në masë të konsiderueshme transparencën e tarifave për përdoruesit fundorë dhe madje edhe reduktime të këtyre tarifave.

#### **2.4. Përmirësimi dhe përditësimi i informacionit në faqen *web* në ndihmë të përdoruesit**

Për t'i ardhur në ndihmë përdoruesit, AKEP ka punuar në përditësimin dhe pasurimin e informacionit në faqen e Internetit. Për këtë qëllim, përvec rubrikës "Përdoruesi" që është vazhdimisht në proces përditësimi, në vitin 2012 është shtuar dhe seksioni "Konsultim i Përdoruesit", ku jepen përgjigje mbi pyetje më të përgjithshme në lidhje me teknologjitë, shërbimet, mënyren e tarifimit, etj.

### **IV. REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË VJETORË TË AKEP**

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 15.02.2012, fondi i shpenzimeve të AKEP, u miratua në shumën 266.000.000 Lekë. Performanca e treguesve ekonomiko-financiarë të AKEP-it, paraqitet në parametrat e pasqyruara më poshtë.

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Plani i vitit 2012</b>	<b>Realizimi i vitit 2012</b>
<b>A</b>	<b>Të ardhurat gjithsej</b>	<b>266,000,000</b>	<b>289,251,403</b>
<b>B</b>	<b>Shpenzimet gjithsej</b>	<b>266,000,000</b>	<b>169,756,954</b>

Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

[www.akep.al](http://www.akep.al)

Faks : + 355 4 2259 106

[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

1	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	75,000,000	65,554,866
2	Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore.	10,000,000	8,282,316
3	Shpenzimet për materiale	5,500,000	3,969,451
4	Shpenzimet për shërbime	35,000,000	28,035,442
5	Shpenzimet për Investime	140,500,000	63,914,878
<b>C</b>	<b>Tarifa e Shërbimit të radiokomunikimit:</b>		<b>326,454,578</b>
1	Arkëtuar dhe transferuar në Buxhetin e Shtetit		326,454,578

### 1. Realizimi i arkëtimeve

Për vitin 2012, të ardhurat janë realizuar në shumën 289,251,403 Lekë nga 266,000,000 Lekë të planifikuara në fillim të vitit, pra me një tejkalim në masën 108,7%. Arkëtimet për vitin 2012 janë realizuar nga pagesat e sipërmarrësve që ofrojnë shërbime dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare. Pagesat që janë kryer në AKEP nga ana e sipërmarrësve janë llogaritur sipas VKM Nr. 599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP” dhe VKD Nr.1532, date 18.03.2011 “Rregullore për licencën e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare”.

Të ardhurat në AKEP janë përfituar nga pagesat:

- Për dhënien dhe përdorimin e frekuencave,
- Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike,
- Për ofrimin e shërbimeve postare,
- Për regjistrimin domain.al dhe nendomain.al,
- Të tjera, (çertifikatë radio operatori, certifikatë miratim tipi, radioamator etj).

Edhe për vitin 2012, nuk është aplikuar pagesa për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike sipas parashikimeve të nenit 24 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, pasi të ardhurat e planifikuara për të mbuluar nevojat e mirëfunksionimit të AKEP, janë realizuar nga kategoritë e pagesave të lartpërmendura.

Një rëndësi të veçantë i është kushtuar dhe ndjekjes së debitorëve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve që ata kanë si ndaj AKEP-it (dhënie në përdorim frekuence, numeracion), ashtu dhe për tarifën e shërbimit të radiokomunikimit. Procesi i mbledhjes së detyrimeve nga sipërmarrësit debitorë është ndjekur nëpërmjet:

- dërgimit të shkresave zyrtare, kontaktimit me telefoni dhe nëpërmjet eëbsite, për shlyerje detyrimi për pagesa në AKEP dhe për tarifë të shërbimit të radiofrekuencave;
- revokimit të autorizimeve individuale për caktim dhe përdorim frekuencash për 40 subjekte debitorë PMR dhe revokim të autorizimeve individuale për caktim numeracioni, për 27 subjekte debitorë.
- Inspektimeve të kryera nga Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit të Spektrit. Janë inspektuar dy operatorë publik debitorë Atel dhe Alfa Telecom dhe pas akt-

inspektimin përkatës, është vendosur masa administrative “gjobë” për mos shlyerje të detyrimeve për AKEP dhe tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit.

## **2. Realizimi i shpenzimeve**

Shpenzimet gjithsej janë realizuar në shumën 169,756,954 Lekë nga 266,000,000 Lekë të planifikuara në fillim të vitit, ose e shprehur në përqindje realizimi ka qënë në masën 63,8 %. Kjo vjen si rrjedhojë e mosrealizimit të shpenzimeve në disa zëra të shpenzimeve administrative dhe investimeve, për të cilat sqarohen më poshtë arsyet e mosrealizimit dhe faza në të cilën ndodhen.

### **2.1.Shpenzimet administrative.**

Shpenzimet administrative, ku përfshihen shpenzimet për paga e shtesa, për sigurime shoqërore e shëndetësore, për materiale dhe për shërbime janë realizuar në shumën 105,842,076 Lekë nga 128,000,000 Lekë të planifikuara, ose 82.6 %.

1. Shpenzime për paga e shpërblime nga 75,000,000 Lekë të planifikuara u realizuan 65,554,866 Lekë ose 87.4 %. Ky realizim relativisht i ulët në krahasim me realizimin e planit, ka ardhur për faktin se fondi në fillim të vitit është planifikuar për 70 punonjës nga 60 që ishte organika në fund të vitit 2011. Kjo shtesë punonjësish nuk u realizua gjatë vitit 2012, pasi nuk është miratuar organika e re.

2. Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga 10,000,000 lekë të planifikuara në fillim të vitit janë realizuar 8,282,316 Lekë ose 82.8 %. Në mosrealizimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore ka ndikuar fakti i mësipërm: mos shtimi i numrit të punonjësve sipas parashikimit.

3. Shpenzimet për materiale janë realizuar në shumën 3,969,451 Lekë nga 5,500,000 Lekë të planifikuara, ose 72 %. Mosrealizimi i zërit të shpenzimeve ka ardhur si rezultat i mirëadministrimit, apo kursimit të shpenzimeve për kancelari, tonera, karburant dhe goma.

4. Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 28,035,442 Lekë nga 35,000,000 Lekë të planifikuara për këtë qëllim, ose 80%. Mosrealizimi i zërit të shpenzimeve për shërbimet, vjen nga mos realizimi i shpenzimeve për marrjen e ambjenteve me qira, kufizimin e shpenzimeve të telefonisë fikse dhe telefonisë celulare, dhe të shpenzimeve për publikime.

### **2.2.Investimet.**

Për vitin 2012, u planifikuan investime në vlerën 140,500,000 Lekë dhe janë realizuar në shumën totale 63,914,878 Lekë, si më poshtë vijon:

- Blerje e një baze të dhënash për “Implementimin e Portabilitetit” dhe mirëmbajtja vjetore nga 28,000,000 lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 27,861,554 lekë;
- Studim projektim godine për AKEP, është paguar 40 % e vlerës së kontratës, pas 1 viti nga dorëzimi i projektit sipas kontratës të realizuar me vlerë 1,104,000 lekë;

- Atlasi Elektronik i Republikës së Shqipërisë, është realizuar në vlerën 2,868,000 lekë, sipas planifikimit po në vlerën 2,868,000 lekë, investim në vazhdim nga viti 2011;
- Shtim i Kapacitetit Teknologjik Hardëare është realizuar në vlerën 2,772,000 lekë, sipas planifikimit, edhe ky investim në vazhdim nga viti 2011;
- Paisje redundant per sistemin Fred të domain-eve ne vlerën 3,972,000 lekë;
- Versioni i ri i programit ARGUS, planifikuar në vlerën 5,700,000 lekë, është realizuar në vlerën 5,595,500 lekë;
- Sistemi i manazhimit të Planit Numeracionit” nga 7,920,000 lekë të planifikuar, u realizua në shumën 7,776,000 lekë;
- U krye pagesa e garancisë së “Qender Kombëtare e rrjetit të testimi të transmetimeve GSM, UMTS etj” nga 2,985,000 leke e planifikuar u realizua ne shumen 2,913,195 lekë;
- Sistemi IT sigurie dhe monitorimi për DSN dhe rrjetin e AKEP me shumën 11,140,000 lekë të kontraktuar, nuk eshte realizuar financimi ne vleren 7,516,000 lekë dhe vazhdon për vitin 2013;
- Gjithashtu janë realizuar, “Blerje e shërbimit të informacionit rregullator” në shumën 1,441,909 lekë;
- Mirëmbajtje dhe zhvillim i sistemit ATLAS në shumën 490,000 lekë;

Nga plani i investimeve për vitin 2012 nuk janë realizuar finacimet e zërave të mëposhtëm:

- Ndërtimi i godinës së AKEP, në shumën 51,969,855 lekë, sepse akoma nuk është miratuar leja e ndertimit të godinës nga Bashkia e Tiranës (në proces);
- Dixhitalizimi i Arshivës AKEP, në shumën 1,920,000 lekë, sepse nuk u finalizua procedura e prokurimit gjatë vitit 2012;
- Konsulencë ndërkombëtare për Ndarjen e Llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Account Separation/Cos accounting- AS/CA) për operatorët me FNT” në shumën 1,700,000 lekë, sepse nuk u realizua procedura e prokurimit gjatë vitit 2012;
- Auditim i llogaritjes kosos të Altelecom në shumën 2,000,000 lekë, sepse nuk u prokurua fondi brenda vitit 2012.
- Sistemi IT sigurie dhe monitorimi për DSN dhe rrjetin e AKEP me shumën 11,140,000 lekë të kontraktuar. Ne vitin 2012 eshte financuar vlera 7,516,000 lekë dhe vazhdon për vitin 2013;
- Asistence teknike për shërbimet Universale me Bankën Botrore në vlerën 1,050,000 lekë. Ky fond qe ka qene kontributi i AKEP per projektin nuk eshte pare i domosdoshem perdorimi i tij gjate vitit 2012 (projekti eshte ne vazhdim).

### ***3. Mbi tepricën e të ardhurave.***

Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2012 rezulton në shumën 119,494,449 Lekë, e cila është përfituar si rezultat i tejkalimit të të ardhurave në shumën 23,251,403 Lekë dhe mosrealizimi i shpenzimeve në shumën 96,243,046 Lekë. Kjo tepricë do të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 3-mujorit të parë të vitit 2013.

#### **4. Mbi taksën e radiokomunikacionit për vitin 2012**

Në referencë të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe AKEP me nr. 28, datë 06.10.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në buxhetin e shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikimit.

Për vitin 2012 janë arkëtuar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit shuma prej 326,454,578 Lekë.

AKEP, ka punuar dhe ndjekur në vazhdimësi mbledhjen e tarifës së radiokomunikimit, gjithashtu ka bashkëpunuar me organet tatimore, për arkëtimin dhe derdhjen në Buxhetin e Shtetit të kesaj tarife te subjekteve debitore.

Në realizimin e detyrës si agjent tatimor, AKEP përfiton një komision në masën 5% të shumës së arkëtuar dhe të derdhur në Buxhetin e Shtetit. Për vitin 2012, shuma e përfituar si agjent tatimor ka qenë 16,322,728 Lekë, dhe 16,320,468 Lekë nga kjo shumë është shpenzuar në formën e shpërblimeve për punonjësit e AKEP.

#### **5. Rritja e performancës dhe efektivitetit në realizimin e treguesve financiarë të AKEP**

AKEP gjatë vitit 2012, ka punuar në rritjen e performancës dhe efektivitetit në realizimin e treguesve financiarë si dhe në administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare duke bërë:

- kontabilizimin në kohë të veprimeve të arkës dhe bankës për të ardhurat dhe shpenzimet që kryen institucioni;
- mbylljen e aktivitetit financiar të vitit 2011, miratimin e bilancit në KD dhe dërgimi i tij brenda afateve ligjore në organet tatimore;
- ndjekjen dhe zbatimin e kontratave për likuidimin në afat të pagesave, sipas kushteve për blerjen e mallrave dhe kryejn e shërbimeve nga të tretët dhe për të tretët;
- ndjekjen e vazhdueshme të sipërmarrësve debitorë për likuidimin e pagesave ndaj AKEP dhe për tarifën e radiokomunikimit dhe bashkëpunimi me organet tatimore;
- informatizimin e llogaritjeve të pagesave dhe mundësimin on-line në faqen e Internetit të AKEP, për sipërmarrësit me qëllim rritjen e transparencës dhe minimizimin e debitorëve;
- inventarizimi i pasurisë së AKEP, dhe për materialet e konsideruara të papërdorëshme është bërë vlerësimi për nxjerrje jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre konform legjislacionit në fuqi.

## V. NGRITJA DHE PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE INFORMATIKE DHE IMPLEMENTIMI I SHËRBIMEVE ON-LINE.

Në përmbushje të objektivit të vendosur në vitin 2011, edhe në periudhën në raportim, AKEP ka punuar për kalimin në *e-Authority*, d.m.th. ofrimin on-line të shërbimeve “konsumatorëve” të tij, si dhe dixhitalizimin e procedurave të brendshme të përpunimit të informacionit. Për këtë qëllim, AKEP ka arritur të realizojë:

- *Sistemin e aplikimit on-line për autorizim e përgjithshëm*

Moduli i Aplikimit on-line për autorizim të përgjithshëm është një modul i bazuar mbi teknologjinë *Web* duke pasur gjithashtu një nivel të lartë sigurie të informacionit. Moduli funksionon në *Web* dhe mundëson aplikimin, analizimin, administrimin, kthim përgjigje dhe ruajtjen e të gjithë korrespondencës për aplikim për autorizim të përgjithshëm nga subjektet në format dixhital on-line.

Ky sistem mundëson rritjen e transparencës dhe zvogëlimin e kohës së përpunimit të aplikimeve. Ndërkohë po punohet që sistemi on-line të implementohet për aplikimet për autorizim individual për frekuenca dhe numeracion.

- *Sistemin e ruajtjes së të dhënave të operatorëve mbi infrastrukturën në formatin on-line WebGIS (ATLAS)*

Implementimi i sistemit “ATLAS” ka realizuar një bazë të dhënash të sakta hartografike në format dixhital për:

- Rrjetin e Fibrave Optike të instaluar në të gjithë territorin e Shqipërisë.
- Rrjetin e Lidhjeve Radio
- Rrjetin e sistemeve GSM/3G (vendodhjen e kullave dhe BTS-ve)

Sistemi ka një portal *WebGIS* (web Geographic Information System), pra teknologji që të dhënat shikohen dhe merren *on-line* nëpërmjet aksesit në internet.

Në vitin 2012, u punua në bashkëpunim me firmen implementuese të sistemit dhe operatorët për grumbullimin, saktësimin dhe standardizimin e të dhënave mbi rrjetet. Në mënyrë të veçantë u punua me operatorët celularë në ndërtimin e shtresave të monitorimit të fuqisë së sinjalit. Matje të konsiderueshme janë realizuar në të gjithë territorin e vendit. Operatorët celularë duhet të implementojë në sistemin ekzistues, në formën e shtresave (layers), të gjitha këto matje në funksion të llojit të shërbimit (GSM apo WCDMA).

Gjithashtu punohet për përmirësimin i funksionaliteteve të ndryshme si kërkim informacioni rreth komponentëve të të dhënave të rrjeteve dhe lidhjeve radio dhe në përmirësimin e sigurisë së programit.

- *Sistemi i Menaxhimit të Planit të Numeracionit*

Sistemi menaxhimit të Planit të Numeracionit ka si qëllim krijimin e një bazë të dhënash të planit të numeracionit, e cila do të shërbejë për të gjitha proceset që lidhen me alokimin e numrave, kërkesat për transferimin e blloqeve të numrave dhe gjithashtu kërkimet on-line të operatorëve apo përdoruesve nëse numri/blloku i numrave është i (zënë, i lirë, i rezervuar apo transferuar). Me implementimin e këtij



sistemi u vihet në ndihmë operatorët dhe ofruesve të shërbimit në aplikimet në kohë reale për alokim numeracioni

▪ *Sistemi dixhital për të dhënat e personelit dhe llogaritjen e listpagesave (Payroll)*

Sistemi dixhital për të dhënat e personelit dhe llogaritjen e pagës së personelit shërben në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të punës. Ky sistem mundëson menaxhimin e të dhënave të punonjësve si dhe menaxhimin e detyrimeve dhe marrëdhënieve kontraktore si për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetsore, paafësinë e përkohshme, tatimet mbi të ardhurat, librin e pagës për cdo person, etj.

▪ *Ngritja e sistemit të raportimeve on-line.*

Zbatimi i sistemit të raportimeve on-line ofron lehtësira për sipërmarrësit në përmbushje të detyrimeve ligjore për dhënie informacioni si dhe automatizon punën rutine të të gjithë sektorëve të AKEP. Ky sistem minimizon kohën e kërkesës dhe raportimit për sipërmarrësit dhe kohën e përgjigjes së AKEP. Në faqen e Internetit të AKEP është instaluar moduli që mundëson kryerjen e llogaritjeve referuese nga ana e subjekteve, para aplikimit për marrje frekuencash, për pagesat për përdorim të frekuencave. Ky sistem rrit transparencën si dhe minimizon mundësitë e rritjes së numrit të subjekteve debitore të AKEP.

Kërkesat dhe raportimet që realizohen janë për:

- a) Autorizim të përgjithshëm
- b) Raportime për interferenca
- c) Llogaritjet financiare referuese për pagesa të përdorimit të frekuencave
- d) Aplikime për numeracion
- e) Aplikime për ofrim shërbime postare
- f) Aplikime për certifikata apo licensa të ndryshme
- g) Raportime për të dhënat e tregut
- h) Deklarimin e tarifave
- i) Treguesit e cilësisë së shërbimit
- j) Të dhënat për treguesit financiarë.

## **VI. STATUSI I REALIZIMIT TE DETYRAVE PER VITIN 2012.**

AKEP, gjatë vitit 2012, ka punuar me një plan të detajuar veprimi të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Më poshtë paraqitet statusi i realizimit të detyrave për vitin 2012, referuar përcaktimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të datës 29.03.2012, "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2012" ku nga AKEP kërkohet :

- **Të angazhohet në forcimin e mëtejshëm të pozitave të tij për mbikqyrjen me transparencë dhe profesionalizëm të mbarëvajtjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe postare;**

AKEP, ushtron funksionet e veta në përputhje me përcaktimet ligjore, politikat sektoriale kombëtare, duke marrë parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit European. Vendimmarrja në AKEP është transparente, e konsultuar me grupet e interesit, profesionale dhe e argumentuar. Për mbikqyrje të tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, AKEP është udhëhequr nga objektivat rregullatore të përcaktuar në ligj: krijimi i një tregu konkurrent me përfitime për përdoruesit, mbrojtja e interesave të përdoruesve dhe krijimi i një klime të favorshme për investitorët.

- **Të angazhohet në një mbikqyrje më të fortë të marrëdhënies mes operatorëve, që operojnë në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare dhe konsumatorit, duke kërkuar nga operatorët që të jenë sa më transparentë dhe korrektë në shërbimet që i ofrojnë atij, duke miratuar dhe ndjekur zbatimin e kuadrit rregullator për publikimin e tarifave**

Sic është theksuar dhe më lart, AKEP, për ti ardhur në ndihmë përdoruesit si inicioi hartimin e një rregulloreje për transparencë të tarifave dhe kushtet e ofrimit të shërbimit nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike. Pas procesit të konsultimit publik, me VKD nr. 2161, datë 21.09.2012, AKEP miratoi Rregulloren Nr. 27 datë 21.09.2012 “*Mbi Publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*”. Nje theks i vecante iu kushtua publikimit te tarifave celulare dhe sidomos tarifave ne roaming, dhe operatoret celulare kane permiresuar ndjeshem kete aspekt te transparences ne ofrimin e sherbimeve.

Gjatë vitit 2012, AKEP miratoi termat dhe kushtet e përgjithshme për 61 kontrata për shërbim telefonik fiks dhe 98 për shërbim aksesi në Internet për 107 sipërmarrës të komunikimeve elektronike. Miratimi i ketyre kontratave rrit mbrojtjen e konsumatorit për shërbimet e komunikimeve elektronike.

Me VKD nr. 2165, date 12.10.2012, AKEP u vendosi detyrime operatorëve për instalimin e Matësit të Shpejtësisë (Speedtest) dhe përfshirjen në kontrata të Treguesve të Cilësisë për aksesin në Internet.

- **Të vazhdojë të angazhohet në uljen e mëtejshme të tarifave të shërbimeve të ofruara në tregun e komunikimeve elektronike**

Gjatë vitit 2012, ka vazhduar tendenca e reduktimit të tarifave të shërbimeve celulare që ka ardhur si pasojë e rritjes së mëtejshme të konkurrencës në treg. Në këto reduktime të tarifave kanë luajtur rol të rëndësishëm vazhdimi i reduktimit të tarifave të tërminimit midis operatorëve si dhe efekti pozitiv i procesit të bartjes së numrit celular.

Për telefoninë fikse Albtelecom ka ofruar paketa të kombinura: telefoni dhe akses në Internet si iFiks. Paketat tarifore të konkurrentëve kryesorë të Albtelecom në telefoninë fikse përmbajnë paketa me pajtim mujor të ulët si dhe me tarifa të ulëta brënda rrjetit si edhe paketa të integruara të telefonisë, Internet dhe televizion në disa raste.

Përsa i përket tarifave për ofrimin e shërbimit Internet, përveç reduktimit të tarifave të përshkruar në seksionin përkatës, Albtelecom ka ofruar rritje (dyfishim) të kapacitetit download për paketat e tij, ndërsa operatorët alternativë kanë qënë gjithashtu aktivë në reduktimin e tarifave të aksesit në Internet dhe tarifat e tyre janë të krahasueshme me ato të Albtelecom.

▪ **Të vazhdojë të angazhohet në menaxhimin me efektivitet të frekuencave 3G**

Bazuar në rezultatet e këshillimit publik të hapur në maj 2012, në lidhje me interesin mbi dy të drejta përdorimi të spektrit ku mbështetet teknologjia për shërbime 3G, AKEP më datë 10.12.2012 zhvilloi tenderin me procedure të hapur për dhënien e njëkohëshme të dy të drejtave të përdorimit të frekuencave. Në këtë proces rezultoi se vetëm oferta e Eagle Mobile sh.a me vlerë 4 000 355 Euro ishte e vlefshme ndërsa oferta tjetër ishte nën cmim minimal të pranueshëm të caktuar në dokumentacion. Sipërmarrësit Eagle Mobile iu lëshua autorizimi për përdorimin e frekuencave ku mbështetet teknologjia që ofron shërbime të standardit 3G, duke u bërë operator i tretë në vend që ofron shërbime të këtij standardi.

▪ **Të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse dhe të nxisë konkurrencën në këtë sektor, duke krijuar një mjedis tërheqës për rritjen e investimeve në linjat fundore të abonentëve**

Sic është theksuar më lart, evolimi i teknologjisë dhe sjelljes konsumatorë në drejtim të paketave të integruara dhe të thjeshta (me përfshirje të minutave në pagesën mujore) dhe rritja e kërkesës për akses në Internet, kanë bërë që shtytësi kryesor për zhvillimin e telefonisë fikse të jetë aksesit broadband në Internet.

Nga Albtelecom dhe operatorët alternativë janë bërë investime të konsiderueshme në rrjetin e fibrave optikë, si dhe në rrjetin e abonenteve për ofrimin e shërbimit të Internetit.

Gjithashtu, portimet e para në rrjetin fiks të realizuara në shtator 2012 në zona gjeografike të caktura, janë premisë për rritjen e konkurrencës dhe zhvillimin e telefonisë fikse.

▪ **Të angazhohet në hartimin e një kuadri të plotë rregullator për funksionimin e tregut postar**

AKEP në vitin 2012, ka punuar për krijimin e kuadrit rregullator të domosdoshëm, pavaresisht mungesës së një njësie që të merret me çështjet të rregullimit postar.

Përveç Rregullore nr. 21 datë 18.03.2011, “Për Licensën e Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare”, në vitin 2012, me VKD Nr. 2231, datë 28.12.2012, është miratuar Rregullore nr. 28, datë 28.12.2012 “Për të dhënat

statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve postare”.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është grumbullimi, evidentimi dhe përdorimi i të dhënave statistikore dhe financiare mbi shërbimet postare, për të nxjerrë përfundimet e nevojshme për analizën dhe tendencat e zhvillimit të tregut postar si dhe përcaktimin e masave përkatëse.

Në faqen e Internetit të AKEP gjendet i publikuar “Regjistri i Ofruesve të Shërbimeve Postare”.

- **Të angazhohet në përafrimin e kuadrit rregullator me atë të Bashkimit Europian**

Ligji 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë“ është hartuar bazuar në paketën rregullatore 2002/2003 të Bashkimit Europian. Bazuar në këtë ligj AKEP, me ndihmë dhe të konsulentëve dhe ekspertëve të BE-së ka miratuar dhe zbatuar 28 rregullore. Me miratimin e ligjit 102/2012, datë 24.10.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë““ u arrit finalizimi i një pune afro tre-vjecare për transpozimin e ndryshimeve të ndodhura në vitin 2009, në paketën rregullatore të BE-së, nepërmjet ndryshimeve dhe shtesave në ligjin 9918. Aktualisht AKEP ka organizuar punën për hartimin e ndryshimeve dhe shtesave në kuadrin rregullator që vijnë si konsekuencë e ndryshimeve të kuadrit ligjor.

- **Të angazhohet në përbushjen e rekomandimeve të dhëna në raport-progreset e BE-së për Shqipërinë**

Raport-progreset e dy viteve të fundit janë me nota pozitive në lidhje me rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri. Gjithashtu, kjo frymë ekziston dhe në takimet e nënkomitetit dhe komitetit të stabilizim-asociimit. Në takimin e fundit të Nënkomitetit mbi Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale të mbajtur në Bruksel më datat 28 dhe 29 Qershor 2012 rekomandimet për AKEP u reduktuan vetëm në 2, krahasuar me ato të nënkomiteteve të mëparshme, dhe respektivisht:

- inkurajimi për vazhdimin e procesit të dhënies së licencave për të gjithë spektrin e mundshëm; dhe

- ndërmarrja e hapave të mëtejshëm në forcimin e kapaciteteve dhe pavarësisë së AKEP.

Këto rekomandime janë mbajtur parasysh në punën e AKEP dhe janë në implementim të vazhdueshëm.

- **Të angazhohet në implementimin e fazave të mëtejshme për tarifat e terminimit të mesazheve SMS në rrjetet e telefonisë së lëvizshme**

Në vijim të vendimeve nr.1710-1713, datë 31.03.2011, për përcaktimin me FNT të katër operatorëve celularë për terminimin e SMS-ve në rrjetet e tyre dhe masat rregulluese për FNT, gjatë vitit 2012, me 1.01.2012 dhe 1.09.2012, u implementuan faza e parë dhe e dytë e reduktimit të tarifave të terminimit të SMS-ve, duke reduktuar këto tarifa nga 3 lek/SMS në 2 lek/SMS.

Reduktimi i tarifave të shumicës ka sjellë reduktim të tarifave ts pakicës dhe rritje të ndjeshme të përdorimit të SMS-ve me 75-83%.

- **Të vazhdojë të angazhohet në implementimin e shërbimit universal, si e vetmja mundësi për ofrimin e shërbimeve bazë edhe në ato zona ku këto shërbime mungojnë apo ofrohen në mënyrë të pamjaftueshme.**

Veprimtaria për implementimin e shërbimit universal trajtohet gjerësisht në pjesën II. “Statusi i Shërbimit Universal dhe Mbrojtja e Përdoruesve”.

## VII. PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2013

Programi i punës së AKEP-it për vitin 2013, ndikohet nga nevoja e tregut, kuadri i politikave kombëtare për sektorin, kërkesat e ligjit 9918, të ndryshuar, rekomandimeve të raport-progresit të BE-së për Shqipërinë si dhe Rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e AKEP.

Për vitin 2013, AKEP do të punojë me prioritet për:

- Plotësimin e kuadrit rregullator në zbatim të ndryshime të kuadrit ligjor me miratimin e ligjit 102/2012, datë 24.10.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë““;
- Kryerjen e analizave të tregut në ofrimin e shërbimeve linja me qira dhe aksesit broadband;
- Miratimin dhe implementimin e rregullave për ndarjen e llogarive dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (AS/CA-Account Separation/Cost Accounting) për operatorët me FNT;
- Arritjen e objektivit të kalimit në e-Authority: ofrimin on-line të të gjithë shërbimeve të AKEP;
- Zhvillimin dhe përditësimin e sistemit të ruajtjes së të dhënave të operatorëve mbi infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike në formatin on-line (projekti ATLAS);
- Miratimin dhe implementimin e ndryshimeve në planin kombëtar të numeracionit; dhe
- Përfundimin e studimit mbi Sistemin Kombëtar të Monitorimit të Frekuencave.

